



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# RAPORT VJETOR 2019

## KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**Tiranë, më 24.04.2020**

*Miratuar me Vendimin Nr. 98, Datë 24.04.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë*

**PËRMBAJTJA**

<b>MESAZH I KRYETARIT .....</b>	<b>4</b>
<b>1. HYRJE .....</b>	<b>7</b>
1.1. KLP DHE GARANCITË KUSHTETUESE PËR PAVARËSINË, LLOGARIDHËNIEN, STATUSIN DHE KARRIERËN E PROKURORIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË .....	7
1.2. ÇËSHTJET KRYESORE QË ANALIZOHEN NË RAPORT .....	8
1.3. KRIJIMI I KLP, KOMPETENCAT SI DHE VENDIMMARRJET E PARA .....	9
1.3.1. <i>Shpallja e vendeve vakante në Prokurorinë e Posaçme</i> .....	10
1.3.2 <i>Komandimi i prokurorëve si këshilltarë në KLP</i> .....	10
1.3.3 <i>Caktimi i numrit të kandidatëve për prokurorë në Shkollën e Magjistraturës</i> .....	11
1.3.4 <i>Ftesa për shprehje interesi për pozicionin e pedagogut në Departamentin e Formimit Fillestar</i> .....	11
1.3.5 <i>Shpallja e fillimit të procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm</i> .....	11
1.4. SEANCAT PLENARE.....	11
1.5. AKTE NËNLIGJORE.....	13
<b>2. RAPORTIM MBI VEPRIMTARINË E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME DHE TË POSAÇME PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2019 .....</b>	<b>15</b>
2.1. KOMISIONET E PËRHERSHME TË KLP.....	15
2.1.1 <i>Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit</i> .....	16
2.1.2 <i>Komisioni i Disiplinës</i> .....	18
2.1.3 <i>Komisioni i Vlerësimit të Veprimitarisë Etike dhe Profesionale</i> .....	20
2.1.4 <i>Komisioni i Zhvillimit të Karrierës</i> .....	24
2.2. KOMISIONET E POSAÇME.....	28
2.2.1 <i>Ngritja dhe përbërja e Komisionit të Posaçëm</i> .....	28
2.2.2 <i>Veprimtaria e Komisionit të Posaçëm</i> .....	29
2.2.3 <i>Takimi me kandidatët dhe çështjet e diskutuara</i> .....	30
2.2.4 <i>Metodologjia e përdorur nga Komisioni</i> .....	31
2.2.5 <i>Vlerësimi përfundimtar i Komisionit</i> .....	32
2.3. KOMISIONET E TJERA (KOMISIONI PËR MBROJTJEN E PROKURORËVE).....	33
2.3.1 <i>Ngritja e Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve</i> .....	33
2.3.2 <i>Veprimtaria e Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve</i> .....	33
2.3.3 <i>Marrëdhëniet e Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve me institucionet e tjera</i> .....	34
<b>3. VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE DHE FINANCIARE E KËSHILLIT.....</b>	<b>34</b>
3.1. ORGANIZIMI I ADMINISTRATËS SË KLP .....	34
3.2. PROCESI I REKRUTIMIT TË NËPUNËSVE CIVILË DHE PUNONJËSVE TË KLP .....	36
3.3. KRIJIMI I DATABASE ME TË DHËNAT E PROKURORËVE NË RSH.....	38
3.4. ANALIZA FINANCIARE DHE BUXHETI .....	39
3.5. PROCESET GJYQËSORE.....	41
<b>4. MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE TË KËSHILLIT .....</b>	<b>42</b>
4.1. MARRËDHËNIET E KLP ME SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS .....	42
4.2. MARRËDHËNIET ME MINISTRINË E DREJTËSISË.....	43
4.3. MARRËDHËNIET ME MINISTRINË PËR EUROPËN DHE PUNËT E JASHTME .....	45
4.4. MARRËDHËNIET ME PROKURORINË E PËRGJITHSHME DHE PROKURORITË E TË GJITHA NIVELEVE.....	45

4.5	MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA TË RIVLERËSIMIT .....	46
4.6	MARRËDHËNIET ME KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË .....	47
<b>5</b>	<b>TRANSPARENCA INSTITUCIONALE E KËSHILLIT .....</b>	<b>48</b>
5.1	PROCESI TRANSPARENT NDAJ INSTITUCIONEVE TË TJERË, PUBLIKUT DHE MEDIAVE .....	48
5.2	PROCEDURAT E NDJEKURA NË KUADËR TË SË DREJTËS PËR INFORMIM .....	49
<b>6</b>	<b>NGRITJA E PROKURORISË SË POSAÇME .....</b>	<b>50</b>
6.1	HARTIMI DHE MIRATIMI I RREGULLORES PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE VLERËSIMIT TË PROKURORËVE NË PROKURORINË E POSAÇME.....	50
6.2	GARA PËR PROKUROR NË PROKURORINË E POSAÇME.....	50
6.3	EMËRIMI I PROKURORËVE TË KONFIRMUAR NË DETYRË DHE GARA PËR DREJTUES TË PROKURORISË SË POSAÇME.....	51
6.4	KANDIDATËT E TJERË PËR PROKUROR NË PROKURORINË E POSAÇME NË PROCES RIVLERËSIMI... ..	52
<b>7</b>	<b>PROCESI I PËRZGJEDHJES SË PROKURORIT TË PËRZGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË.....</b>	<b>53</b>
7.1	RREGULLORJA DHE SHPALLJA .....	53
7.2	VERIFIKIMI I KUSHTEVE LIGJORE.....	53
7.3	MIRATIMI I LISTËS PARAPRAKE TË KANDIDATËVE PËR PROKUROR TË PËRZGJITHSHËM .....	54
7.4	MIRATIMI I LISTËS PËRFUNDIMTARE TË KANDIDATËVE PËR PROKUROR TË PËRZGJITHSHËM.....	55
7.5	ZGJEDHJA E PROKURORIT TË PËRZGJITHSHËM NGA KUVENDI.....	55
<b>8</b>	<b>AKTIVITETE NË KUADËR TË BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR .....</b>	<b>56</b>
<b>9</b>	<b>KONKLUZIONE .....</b>	<b>58</b>
<b>10</b>	<b>PRIORITETET E KËSHILLIT PËR TRI VITET NË VIJIM.....</b>	<b>59</b>
10.1	OBJEKTIVAT E KLP PËR VITIN 2020 .....	59
10.2	PLANI STRATEGJIK I KLP (2020-2024) .....	60

### MESAZH I KRYETARIT

I nderuar Z. Kryetar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Sot kam kënaqësinë të ndaj me Ju raportin e parë vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Paraqitja e këtij raporti është për Ne një mundësi e mirë për t'i bërë të ditur Kuvendit, institucioneve partnere dhe të gjithë shoqërisë, një përmbledhje të veprimtarisë së Këshillit në këtë përvjetor të parë.

Siç e dini, Kushtetuta e ka mandatuar Këshillin e Lartë të Prokurorisë që të veprojë në prapavijë të sistemit të prokurorisë, me qëllimin për të krijuar kushtet për suksesin e këtij sistemi në goditjen penale të krimit. Nga ana tjetër, sukcesi në luftën penale kundër krimit është i mundur vetëm nëse prokurorët e Republikës janë profesionalë, të pavarur dhe me integritet. Pikërisht këto 3 fjalë (profesionalizmi, pavarësia dhe integriteti i prokurorëve) përmbledhin në mënyrë lakonike qëllimin dhe objektin e punës së Këshillit të cilit i jemi kushtuar gjatë vitit që shkoi.

Reforma e vitit 2016 themeloi Këshillin e Lartë të Prokurorisë si organ të pavarur me përgjegjësi ekskluzive në fushën e statusit të prokurorëve. Përgjegjësitë e Këshillit shtrihen mbi të gjithë ciklin e jetës profesionale të prokurorëve përfshi pranimin e kandidatëve për prokurorë në Shkollën e Magjistraturës, emërimin, caktimin në pozicione, transferimin, ngritjen në detyrë dhe disiplinimin. Natyrisht, të gjitha këto vendime të rëndësishme nuk mund të jenë arbitrare. Është gjithashtu në misionin e Këshillit që vendimet e sipërpëmendura mbi karrierën e prokurorëve të bazohen ekskluzivisht në vlerësimin e meritave profesionale të tyre dhe verifikimin e figurës dhe të integritetit të tyre në faza e momente të ndryshme të karrierës.

Ky set kompetencash i është veshur pikërisht Këshillit sepse ai është një organ i zgjedhur në mënyrë meritokratike, profesionale dhe të depolitizuar, si dhe ka një përbërje që mundëson balancimin e interesave të prokurorëve me ato të shoqërisë në përgjithësi.

Kjo formulë e zgjuar mundëson realizimin e njëkohshëm të disa qëllimeve: nga njëra anë vetë prokurorët përfshihen në mënyrë të efektshme dhe demokratike në vetëqeverisjen e sistemit; nga ana tjetër, Kuvendi, përmes përfaqësuesve të tij në Këshill, bashkëqeveris sistemin e prokurorisë në emër dhe për llogari të shoqërisë, krahas krahas me trupën e prokurorëve. Një nga meritat e formulës është gjithashtu depolitizimi i anëtarëve jo prokurorë të Këshillit, falë një procesi përzgjedhës meritokratik e të depolitizuar, pavarësisht faktit se emërimi bëhet në fund nga një organ politik si Kuvendi.

Ne jemi të vetëdijshëm se veprimtaria e Këshillit gjatë vitit 2019 është shënjuar nga themelimi i Prokurorisë së Posaçme dhe zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm. Ndërsa jemi pa dyshim krenarë për arritjet në këto 2 drejtime, duam të theksojmë se veprimtaria e Këshillit ka qenë në fakt shumë më e gjerë dhe e thellë.

Vetëm për të përmendur disa prej aspekteve më të spikatura të punës tonë gjatë vitit 2019 do të veçoja faktin se, gjatë vitit që shkoi, ne kemi themeluar një sistem të vetting-ut permanent të prokurorëve i cili, së bashku me sistemin disiplinor, do të shndërrohet, hap pas hapi, në gurin e themelit të integritetit në sistemin e prokurorisë.

Po kështu gjatë këtij viti Ne kemi hedhur themelet e meritokracisë në sistemin e prokurorisë duke hartuar rregulla, sa komplekse aq të efektshme, për identifikimin dhe individualizimin e rezultateve profesionale të prokurorëve dhe përdorimin e këtyre rezultateve si bazë ekskluzive për të gjitha vendimet e Këshillit mbi karrierën e prokurorëve.

Për të mësuar më tepër përsa më sipër dhe gjithçka tjetër Ju ftoj të lexoni raportin vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2019.

**K R Y E T A R**

Gent Ibrahimi

*Lista e akronimeve*

KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KLGG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
KPA	Kolegji i Posaçëm i Apelit
ILD	Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë
Ligji për qeverisjen	Ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar
Ligji për statusin	Ligji nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
Ligji për prokurorinë	Ligji nr. 97/2016, “Për organizim dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”
Ligji për rivlerësimin	Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
Komisioni i Karrierës	Komisioni i Zhvillimit të Karrierës
Komisioni i Vlerësimit	Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional
Komisioni i Buxhetit	Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit
Prokuroria e Posaçme	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
EURALIUS	EU Funded Project
OPDAT	Office of Overseas Prosecutorial Development, Assistance and Training/ Zyra Tejoqeanike për Zhvillimin, Ndihmën dhe Trajnimin e Prokurorisë.

### 1. HYRJE

#### 1.1. KLP DHE GARANCITË KUSHTETUESE PËR PAVARËSINË, LLOGARIDHËNIEN, STATUSIN DHE KARRIERËN E PROKURORIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në vitin 2016, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një reformë rrënjësore dhe gjithëpërfshirëse kushtetuese dhe ligjore për organizimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë. Shkaqet kryesore të kësaj reforme lidheshin me mbizotërimin në sistemin e drejtësisë të fenomeneve negative si: korrupsioni, ndikimi politik, mungesa e profesionalizmit, eficiencës, transparencës si dhe aksesit në drejtësi, etj., shkaqe të cilat çuan në dobësimin e shtetit të së drejtës dhe humbjen e besimit të shtetasve tek sistemi i drejtësisë.

Reforma në drejtësi nisi me ndryshimet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe u pasua me miratimin e disa ligjeve të posaçme, të cilat ndryshuan në mënyrë thelbësore organizimin dhe funksionimin e institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, u krijua KLP<sup>1</sup>, si organ që administron karrierat e prokurorëve.

Sistemi i drejtësisë, përmes institucioneve të reja që e përbëjnë atë si, KLP, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, etj., duhet të sigurojë zbatimin e parimeve kushtetuese se, *të gjithë janë të barabartë përpara ligjit* dhe se, *sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor*<sup>2</sup>.

Legjislacioni i mësipërm rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë duke vendosur garancitë e nevojshme ligjore për pavarësinë, llogaridhëniën, transparencën dhe eficiencën<sup>3</sup> në dhëniën e drejtësisë njësoj për të gjithë shtetasit, pa dallim për shkak të funksionit shtetëror apo pozitës sociale.

Kuadri ligjor ka vendosur standarde të mira për ushtrimin e detyrës së prokurorit në mënyrë të pavarur dhe efikase. Përveç respektimit të parimeve të ligjshmërisë, objektivitetit, paanshmërisë dhe zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme të prokurorit më të lartë, veprimtaria e Prokurorisë duhet të ushtrohet duke respektuar garancitë sa i takon pavarësisë dhe autonomisë së nevojshme të prokurorëve në marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit të funksionit të tyre kushtetues dhe ligjor nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm, nga çdo autoritet publik apo privat.

Përveç pavarësisë procedurale të Prokurorëve gjatë hetimit dhe përfaqësimit të akuzës, legjislacioni i mësipërm garanton të drejtën e prokurorëve për të kundërshtuar udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm apo drejtuesit të prokurorive, nëse vlerësojnë se ato janë të paligjshme apo të pabazuara. Në respekt të parimeve të ligjshmërisë dhe

<sup>1</sup> KLP është krijuar me Vendimin nr. 1, datë 19.12.2018

<sup>2</sup> Nenet 7 dhe 18/1, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

<sup>3</sup> Neni 2, i Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

procedimit të drejtë dhe të barabartë, ligji rregullon edhe procedurën e zëvendësimit të prokurorit dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit për zëvendësimin e tij në një çështje penale.

Shqipëria, si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Europian është angazhuar për ndërmarrjen e reformave që lidhen me BE-në dhe veçanërisht, në trajtimin e 5 prioriteteve kyçe të identifikuara për hapjen e negociatave për anëtarësim si: lufta ndaj krimit në përgjithësi dhe atij të organizuar në veçanti, lufta kundër korrupsionit, krijimi i një administrate publike të kualifikuar dhe të depolitizuar, përmirësimi i veprimtarisë dhe forcimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor, si dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.

KLP është aktor kyç për realizimin e pjesës më të madhe të këtyre prioriteteve.

### 1.2. ÇËSHTJET KRYESORE QË ANALIZOHEN NË RAPORT

Në Raportin e Veprimtarisë për vitin 2019 jepet informacion i detajuar mbi veprimtarinë e KLP gjatë këtij viti<sup>4</sup>, duke patur parasysh vonesën dhe vështirësitë për ngritjen dhe funksionimin e këtij institucioni, në përputhje me parashikimet ligjore.

Në periudhën objekt i këtij raporti, në mënyrë të përmbledhur, KLP ka trajtuar çështje që lidhen kryesisht me:

- a) *rregullimin e veprimtarisë së KLP;*
- b) *rregullimin e disa aspekteve të veprimtarisë së prokurorëve nëpërmjet miratimit të rregulloreve të ndryshme;*
- c) *statusin e prokurorëve duke përfshirë emërimin e magjistratëve të rinj, krijimin e Prokurorisë së Posaçme, përzgjedhjen dhe vlerësimin e kandidatëve për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm, etj;*
- d) *raportimet në kuadër të procesit të integritetit të vendit në Bashkimin Europian.*

Në raport informohet mbi veprimtarinë e realizuar nga Komisionet e Përhershme të KLP, aktet nënligjore të miratuara, marrëdhëniet me Shkollën e Magjistraturës, veprimtarinë administrativo-financiare, raportet me institucionet e tjera etj.

Ky raport është mbështetur në Vendimin nr. 134/2018, “Për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se institucionet e pavarura referojnë në këtë manual gjatë ndjekjes dhe zbatimit të Vendimit nr. 49/2017. “Për krijimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”.

<sup>4</sup>Raporti i pjesshëm i veprimtarisë është miratuar me Vendimin nr. 170, datë 27.09.2019, të KLP.



### 1.3. KRIJIMI I KLP, KOMPETENCAT SI DHE VENDIMMARRJET E PARA

Neni 149, i Kushtetutës parashikon se, KLP është organ kolegjal i përbërë nga 11 anëtarë, nga të cilët 6 anëtarë zgjidhen nga radhët e prokurorëve të të gjitha niveleve dhe 5 anëtarë zgjidhen nga Kuvendi midis radhëve të juristëve të spikatur.

KLP zhvilloi mbledhjen e tij të parë më datë 19.12.2018. Në mbledhje morën pjesë 11 anëtarë. Mbledhja u drejtua nga anëtari jomagjistrat më i vjetër në moshë, Znj. Nurihan Seiti, në përputhje me nenin 280, të Ligjit për qeverisjen.

Në mbledhjen e parë konstitutive, KLP zgjodhi kryetar Z. Gent Ibrahimi dhe zëvendëskryetar të Këshillit Z. Alfred Balla.

Gjithashtu u hodh shorti për kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të Këshillit, i cili rezultoi si më poshtë:

- Z. Gent Ibrahimi                      3 vjet
- Z. Sandër Beci                        3 vjet
- Znj. Antoneta Sevdari               3 vjet
- Z. Arben Dollapaj                    3 vjet

Anëtarët e tjerë të KLP, Z. Kostaq Beluri (3 vjet), Z. Bujar Sheshi, Znj. Nurihan Seiti, Z. Alfred Balla dhe Z. Tartar Bazaj kanë mandat 5-vjeçar.

KLP, prej momentit të krijimit, duke u bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, është përgjegjëse për karrierën në tërësi të prokurorëve. Kështu, në Nenin 149/a të Kushtetutës, përcaktohet se, KLP:

- a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;*
- b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;*
- c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, sipas ligjit;*
- ç) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre;*
- d) propozon dhe administron buxhetin e tij;*
- dh) informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë;*
- e) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.”*

Gjithashtu, Neni 159, i Ligjit për qeverisjen, ndër të tjera, përcakton në mënyrë më të detajuar kompetenca të tjera si:

- 1. KLP organizohet dhe e ushtron veprimtarinë e tij në mbledhje plenare ose në komisione.*
- 2. KLP në mbledhjen plenare ushtron kompetencat e mëposhtme:*
  - a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;*

- b) vendos masa disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;*
- c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi;*
- ç) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre;*
- d) propozon dhe administron buxhetin e tij;*
- dh) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e prokurorisë;*
- e) miraton akte nënligjore normative, në zbatim të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, me ndikim të përgjithshëm detyruës për të gjithë prokurorët;*
- ë) miraton aktet për rregullimin e procedurave të brendshme të Këshillit;*
- f) miraton Kodin e Etikës së Këshillit;*
- g) shqyrton, sipas rastit, vendimet e komisioneve;*
- gj) miraton udhëzime jodetyruese;*
- h) miraton rregullat e hollësishme për funksionimin e administratës së Këshillit;*
- i) miraton përbërjen e komisioneve të përhershme, të komisioneve të përkohshme, si dhe rregulla të detajuara për funksionimin e tyre...*

---

### **1.3.1. SHPALLJA E VENDEVE VAKANTE NË PROKURORINË E POSAÇME**

Menjëherë pas krijimit të tij dhe në ushtrim të këtyre kompetencave kushtetuese dhe ligjore, në muajin Janar 2019, KLP shpalli fillimin e procedurave për plotësimin e 15 (pesëmbëdhjetë) pozicioneve vakante në Prokurorinë e Posaçme. Për shkak të numrit të ulët të kandidaturave që shprehën interes në thirrjen si dhe me qëllim konkurrencën dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë, KLP vendosi të shtyjë afatin e pranimit të aplikimeve për këto pozicione.<sup>5</sup>

---

### **1.3.2 KOMANDIMI I PROKURORËVE SI KËSHILLTARË NË KLP**

Në përputhje me nenin 53/2, të Ligjit për statusin dhe nenin 176/3, të Ligjit për qeverisjen, KLP ftoi të gjithë prokurorët e shkallës së parë dhe të dytë, të cilët nuk shërbenin në një pozicion me mandat të kufizuar dhe që nuk ishin të komanduar në ndonjë pozicion tjetër, të shprehnin interesin për t'u komanduar në pozicionin e Këshilltarit pranë KLP. Në përputhje me procedurat ligjore, fillimisht u komanduan 6 prokurorë.

---

<sup>5</sup>Vendim nr. 10/1, datë 07.01.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

### **1.3.3 CAKTIMI I NUMRIT TË KANDIDATËVE PËR PROKURORË NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS**

Në zbatim të Ligjit për qeverisjen, të Ligjit për statusin, si dhe Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, KLP caktoi numrin e kandidatëve për prokurorë në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2019-2020<sup>6</sup>.

### **1.3.4 FTESA PËR SHPREHJE INTERESI PËR POZICIONIN E PEDAGOGUT NË DEPARTAMENTIN E FORMIMIT FILLESTAR**

Në përputhje me nenet 53 dhe 54, të Ligjit për statusin dhe nenin 264 të Ligjit për qeverisjen, dhe Vendimit nr. 6 datë 29.01.2019, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, KLP ftoi të gjithë prokurorët që plotësonin kriteret ligjore, të shprehnin interesin për pozicionin e pedagogut të brendshëm, në departamentin e Formimit Fillestar, pranë Shkollës së Magjistraturës, përmes procedurës së komandimit.

### **1.3.5 SHPALLJA E FILLIMIT TË PROCEDURËS PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE PËR PROKUROR TË PËRGJITHSHËM**

Në muajin mars 2019, KLP, bazuar në nenin 148/a, paragrafi 3 të Kushtetutës, Seksionit I dhe II të Kreut IV, të Ligjit për prokurorinë, shpalli fillimin e procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm, përmes procedurës së hapur të thirrjes publike për aplikim, bazuar në Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm”, të miratuar nga KLP.

## **1.4. SEANCAT PLENARE**

Që nga momenti i zhvillimit të mbledhjes së tij të parë dhe deri fund të vitit 2019, KLP duhet jo vetëm të ngrihej si institucion, por edhe t'i përgjigjej sa më shpejt detyrimeve ligjore. Për këtë periudhë raportimi, KLP ka zhvilluar 39 mbledhje plenare dhe janë marrë 278 vendime për çështje të ndryshme.

Pas zgjedhjes së organeve drejtuese, të kryetarit dhe të zëvendëskryetarit, si dhe të anëtarëve, të cilët do të ushtrojnë detyrën me mandat 3-vjeçar, vlen të theksojmë se,


---


<sup>6</sup>Vendim nr. 21, datë 28.01.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

përgjatë kësaj periudhe, KLP ka miratuar 11 vendime të karakterit nënligjor, ashtu sikurse vendime të tjerë, të cilët kanë të bëjnë me ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të përhershme dhe të Komisioneve të përkohshme.

Disa nga çështjet me të cilat u përball KLP, të cilat kërkonin ndërhyrje të menjëhershme, paraqiten më poshtë:

- a) Vakumi në sistemin e drejtimit në prokuroritë, si pasojë e shkarkimit të drejtuesve të prokurorive gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar;
- b) Nisja e procesit të krijimit të Prokurorisë së Posaçme;
- c) Nisja e procesit të emërimit dhe caktimi në detyrë i magistratëve, të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018 dhe pranimet e reja në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2019-2020;
- ç) Ngritja e strukturës përkatëse për vijimin e bashkëpunimit me institucionet e rivlerësimit kalimtar;
- d) Ngritja e Komisioneve të përhershme dhe Komisioneve të përkohshme, sipas parashikimeve ligjore, si një domosdoshmëri për të shqyrtuar çështje të veçanta;
- e) Nisja dhe përfundimi i procedurave për përzgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm.





### 1.5. AKTE NËNLIGJORE

Në mbështetje të neneve 149 dhe 179/6, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 280, të Ligjit për qeverisjen, të Vendimit nr. 19/2018, “Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, dhe të Vendimit datë 11.12.2018, të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve “Për rezultatin e zgjedhjeve dhe shpalljen e fituesve”, me Vendimin nr. 1, datë 19.12.2018, “Për krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, anëtarët e KLP deklaruan krijimin e Këshillit, bazuar në vlerat e pavarësisë, llogaridhënies, meritokracisë, integritetit dhe profesionalizmit.

Me Vendimin nr. 2, datë 19.12.2018, të KLP është miratuar Rregullorja “Për procedurën e zgjedhjes së kryetarit dhe zëvendës kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”. Ndërsa, me Vendimin nr. 3, datë 19.12.2018, të KLP, janë zgjedhur kryetari dhe zëvendëskryetari i këtij Këshilli. Me Vendimin nr. 6, datë 19.12.2018, të KLP është miratuar përbërja e Komisioneve të përhershme pranë këtij Këshilli. Ndërsa, me Vendimin nr. 10, datë 7.1.2019, KLP ka vendosur fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për prokurorë, të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2017-2018.

KLP ka miratuar Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”<sup>7</sup>, e ndryshuar, rregullore e cila ka për qëllim përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për ngritjen në detyrë të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme, bazuar në

<sup>7</sup> Vendim nr. 51, datë 29.3.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

një proces objektiv, transparent dhe gjithëpërfshirës, me synim përzgjedhjen e një trupe prokurorësh të aftë.

KLP ka ngritur një Komision të Posaçëm për vlerësimin e kandidatëve për Prokurorinë e Posaçme. Ai ka miratuar “Metodologjinë e punës së Komisionit të Posaçëm për vlerësimin e kandidatëve për Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, me qëllim që të lehtësojë punën e Komisionit në zbatim të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, për të siguruar një proces objektiv, transparent dhe gjithëpërfshirës.

Gjithashtu, KLP ka miratuar Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”<sup>8</sup>, rregullore në të cilën janë përcaktuar kriteret dhe procedurat që lejojnë Këshillin të kryejë një proces objektiv, transparent, dhe gjithëpërfshirës për përzgjedhjen, renditjen dhe propozimin e tre kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm.

Në mbështetje të nenit 143, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, të nenit 9, të Ligjit për statusin, Vendimit nr. 34, datë 10.04.2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe nenit 189/1/c, të Ligjit për qeverisjen, KLP ka miratuar Rregulloren “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”<sup>9</sup>, e cila përcakton rregulla të detajuara që lidhen me aktivitetin e prokurorit jashtë funksionit.

KLP ka miratuar Rregulloren “Për vlerësimin etik dhe profesional të subjekteve në procesin e rivlerësimit”<sup>10</sup>, si dhe rregullat për kryerjen e praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës.

Bazuar në nenin 59, të Ligjit për statusin, KLP ka miratuar Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”<sup>11</sup>, rregullore në të cilën janë përcaktuar parimet, kriteret dhe procedurat për caktimin e përkohshëm të prokurorëve në pozicione të përkohshme, të krijuara në sistemin e prokurorisë. Procedura e caktimit të përkohshëm kryhet në përputhje me parimin e ligjshmërisë, objektivitetit, efijencës dhe transparencës.

KLP ka miratuar Rregulloren “Për pagesat e prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit zyrtar”<sup>12</sup>, e cila ka vendosur rregulla të detajuara për kompensimin financiar të prokurorëve, të cilët punojnë jashtë orarit zyrtar, ditët e pushimeve dhe festave zyrtare për shkak të shërbimit të gatishmërisë, masave të sigurimit apo çdo rasti tjetër sipas nevojave të funksionit që buron nga parashikimet e Kodit të Procedurës Penale apo ligje të tjera.

---

<sup>8</sup>Vendim nr. 50, datë 19.03.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

<sup>9</sup>Vendim nr. 26, datë 22.02.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

<sup>10</sup>Vendim nr. 45, datë 19.03.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

<sup>11</sup>Vendim nr. 64, datë 15.04.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

<sup>12</sup>Vendim nr. 91, datë 13.05.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 159 dhe 178, pika 2, të Ligjit për qeverisjen, KLP ka miratuar strukturën organizative të administratës së Këshillit.<sup>13</sup>

KLP ka miratuar edhe një Rregullore “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”<sup>14</sup>.

Gjithashtu, janë miratuar dy metodologji të rëndësishme, për dy procese si: Metodologjia lidhur me vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm<sup>15</sup>, dhe Metodologjia për vlerësimin e kandidatëve për drejtues të Prokurorisë së Posaçme<sup>16</sup>.

Për më tepër, është miratuar edhe Rregullorja “Për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimin mbi bazën e parimit të rotacionit të avokatit të mbrojtjes, nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në procesin penal”<sup>17</sup>.

Së fundi, në kuadër të ngritjes së Prokurorisë së Posaçme, KLP ka marrë vendimin “Për miratimin e rregullave të transferimit të personelit administrativ të Prokurorive të Krimeve të Rënda”<sup>18</sup>.

## 2. RAPORTIM MBI VEPRIMTARINË E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME DHE TË POSAÇME PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2019

### 2.1. KOMISIONET E PËRHERSHME TË KLP

KLP është i organizuar në katër komisione të përhershme, si vijon:

**Komisioni i Buxhetit** i cili kryesohet nga Kryetari i Këshillit Z. Gent Ibrahimimi dhe ka në përbërje të tij: Znj. Nurihan Seiti dhe Z. Vatë Staka (i cili ka zëvendësuar znj. Antoneta Sevdari). Anëtar zëvendësues i këtij komisioni është Z. Alfred Balla.<sup>19</sup>

**Komisioni i Disiplinës** kryesohet nga Z. Bujar Sheshi dhe ka në përbërje të tij Z. Tartar Bazaj<sup>20</sup>. Anëtar zëvendësues i këtij komisioni është Znj. Nurihan Seiti.

<sup>13</sup>Vendim nr. 36, datë 06.03.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

<sup>14</sup> Vendimi nr. 171, datë 27.09.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

<sup>15</sup>Vendimi nr. 229, datë 12.11.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

<sup>16</sup> Vendimi nr. 237, datë 25.11.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

<sup>17</sup>Vendimi nr. 231, datë 12.11.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

<sup>18</sup>Vendimi nr. 282, datë 19.12.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

<sup>19</sup> Ish anëtar i këtij komisioni, Z. Arben Dollapaj u shkarkua me vendim nr. ...., datë të KPA.

<sup>20</sup> Ish anëtar i këtij komisioni, Z. Besnik Cani u shkarkua me vendim nr. ...., datë të KPA.

**Komisioni i Vlerësimit** kryesohet nga Z. Alfred Balla dhe ka në përbërje të tij: Z. Kostaq Beluri dhe Znj. Esmeralda Keshi (e cila ka zëvendësuar ish anëtarin Gentjan Osmani). Anëtar zëvendësues i këtij komisioni është Z. Tartar Bazaj.

**Komisioni i Karrierës** kryesohet nga Z. Sandër Beci dhe ka në përbërje të tij Z. Vatë Staka (i cili ka zëvendësuar Znj. Antoneta Sevdari)<sup>21</sup>. Anëtarë zëvendësues të këtij komisioni janë: Z. Bujar Sheshi dhe Z. Gent Ibrahimimi.

### **2.1.1 KOMISIONI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, ADMINISTRIMIT DHE BUXHETIT**

Komisioni i Buxhetit ka propozuar gjatë mbledhjeve plenare të KLP, marrjen e vendimeve në lidhje me buxhetin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore si për vitin 2019, ashtu edhe në kuadrin e përgatitjes së projektbuxhetit afatmesëm 2020-2022. Kështu, Komisioni gjatë vitit 2019, ka propozuar marrjen e vendimeve në lidhje me:

- f) Buxhetin e vitit 2019 dhe strukturën organizative përkatëse;
- g) Miratimin e kërkesave buxhetore në fazën e planifikimit strategjik për vitin 2020-2022.
- h) Miratimin e kërkesave buxhetore në fazën teknike të projektbuxhetit afatmesëm për vitin 2020-2022.

Komisioni, me mbështetjen e një stafi të kufizuar specialistësh, ndërmori punën për përgatitjen e buxhetit të vitit 2019, punë e cila u finalizua me Vendimin e KLP nr. 17, datë 21.01.2019, i cili iu përcoll Kuvendit të Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

REALIZIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2019

000/lek

Nr.	ZËRAT E SHPENZIMEVE	QERSHOR - DHJETOR 2019		
		PLAN	FAKT	REALIZIMI %
1	<i>Paga</i>	60000	32349	54%
2	<i>Sigurime Shoqërore</i>	8000	3158	39%
3	<i>Mallra dhe Shërbime</i>	20000	17858	89%
4	<i>Investime</i>	20000	10 500	53%
	<b>Totali</b>	<b>108000</b>	<b>63 865</b>	<b>59%</b>

<sup>21</sup> Ish anëtari i këtij komisioni, Z. Arben Dollapaj u shkarkua me vendim nr. ...., datë të KPA.



Sipas këtij Vendimi, kërkesat buxhetore të KLP, për vitin 2019, llogariteshin në 215 milion lekë, me një numër prej 75 punonjësish. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi një numër prej 65 punonjësish dhe Këshilli i Ministrave bazuar në këtë Vendim, alokoi një buxhet vjetor prej 108 milionë lekë për periudhën shtatë mujore, duke filluar efektet financiare më 1 Qershor 2019. Për periudhën deri në miratimin e buxhetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë bëri një zgjidhje teknike provizore për pagat dhe sigurimet shoqërore, duke i përballuar këto shuma nga buxheti i Prokurorisë së Përgjithshme.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat e realizimit të buxhetit për periudhën qershor- dhjetor 2019.

KLP dhe stafi mbështetës ka punuar dhe vazhdon të punojë me një mungesë mjedisesh dhe ka në dispozicion disa zyra pune, të lëshuara përkohësisht nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë.

Zgjidhja e mundësuar nga Këshilli i Ministrave për vendosjen e KLP në ndërtesën e “Polit të Drejtësisë” është pa dyshim një zgjidhje efikase, gjë e cila do të mundësojë një veprimtari normale të institucionit. KLP do të zhvendoset në ambientet e reja brenda 6 muajve të parë të vitit 2020.

Krahas përgatitjeve për vendosjen e stafit të KLP në mjediset e reja, është intensifikuar puna për rekrutimin e plotë të administratës së këshillit. Kështu deri në fund të vitit 2019 ishin rekrutuar 32 punonjës (përveç 11 anëtarëve të zgjedhur dhe 6 magjistratëve të komanduar këshilltarë). Në këtë kuadër, po i kushtohet në vazhdimësi një kujdes i veçantë rekrutimit, me synimin që të vijojë përzgjedhja e një stafi cilësor dhe me integritet të lartë moral dhe profesional.


Për sa më sipër, është evidentuar si prioritet nevoja e rekrutimit të stafit mbështetës të Komisioneve, i cili ka pasur në të vërtetë, një impakt të drejtpërdrejtë në punën dhe eficiencën e Këshillit.

Komisioni i Buxhetit, gjatë vitit 2019, me mbështetjen e stafit teknik, është angazhuar për përgatitjen e projektbuxhetit afatmesëm për vitin 2020-2022. Bazuar në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Ligjin për qeverisjen, komisioni hartoi kërkesat buxhetore, të cilat janë bërë objekt i vendimmarrjes së Këshillit (pas përfundimit të fazës strategjike dhe teknike).

Kërkesat buxhetore të KLP, për vitin 2020-2022, janë dukshëm më të larta se tavanet buxhetore të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në Ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”. Kërkesat buxhetore të KLP rezultojnë të jenë rreth 207 milion lekë, dhe një numër prej 83 punonjësish ndërsa tavanet buxhetore të miratuara për vitin 2020 parashikojnë një buxhet në shumën 152 milion lekë dhe një numër prej 65 punonjësish, ose 36% më të ulta se kërkesat tona.

Kështu, siç është parashikuar edhe në PBA 2020-2022, për shkak të ngarkesës së madhe të punës që ka ky institucion, vazhdon të jetë domosdoshmëri shtimi me burime njerëzore i stafit mbështetës, për të siguruar mirëfunksionimin dhe eficiencën e plotë të Komisioneve dhe të Këshillit.

Nëse do t'i referohemi strukturës buxhetore sipas tavaneve buxhetore të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, rezulton se 75% e buxhetit për KLP, e zënë pagat dhe sigurimet shoqërore, shpenzime operative 14 % të buxhetit, 11% investimet.



Ndërkohë, nevojat e këtij institucioni kërkojnë burime financiare suplementare për investime, pajisje, teknologji informative, trajnime, por edhe mallra e shërbime cilësore, të cilat rrisin cilësinë dhe efikasitetin e punës së institucionit.

Gjatë vitit 2019, KLP është mbështetur për nevojat e veta për pajisje për infrastrukturën elektronike të nevojshme nga misioni OPDAT nëpërmjet dhurimit të një sërë pajisjesh të tilla përfshirë kompjuter, laptop, printer, skaner, UPS server etj.

### 2.1.2 KOMISIONI I DISIPLINËS

Komisioni i Disiplinës është krijuar me Vendimin e KLP Nr. 6, datë 28.12.2018, “Për krijimin e komisioneve të përhershme pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, në mbështetje të nenit 160 të Ligjit për qeverisjen.

Që në fillim theksojmë se veprimtaria e Komisionit të Disiplinës së KLP gjatë vitit 2019 ka qenë e kufizuar për shkak të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe vonesave në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Që në fillim të vitit 2019 veprimtaria e Komisionit të Disiplinës ka qenë e kufizuar, duke mos e ushtruar në mënyrë të plotë dhe eficiente kompetencat që ligji i ka ngarkuar, për shkak se Gjykata Kushtetuese me Vendimet Nr. 41/2017 dhe Nr. 78/2017, ka shfuqizuar

disa dispozita të Ligjit për qeverisjen, lidhur me procedurën e ndjekur në rastet e shkeljeve disiplinore që parashikoheshin në nenet 100 deri 159 të Ligjit për statusin.

Mangësitë e mësipërme ligjore u plotësuan me miratimin e Ligjit Nr. 47/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin për qeverisjen. Këto ndryshime përmirësuan kuadrin ligjor për sa i takon shkeljeve disiplinore të anëtarëve të KLP sikurse u shtuan edhe tre nene të reja, në të cilat është bërë një ndarje e shkeljeve disiplinore, sipas natyrës së tyre në:

- a) shkelje disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit;
- b) shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit;
- c) shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale.

Njëkohësisht me Ligjin Nr. 48/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, u plotësua kuadri ligjor sa i takon shkeljeve disiplinore të magjistratëve. Ndonëse këto ligje hynë në fuqi në muajin Gusht 2019, Komisioni i Disiplinës nuk arriti të vijojë punën normalisht në ushtrim të funksioneve të ngarkuara nga ligji, për shkak se ende gjatë vitit 2019 nuk u arrit të krijohet institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si hallka kryesore e procesit disiplinor të magjistratëve.

Mungesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është bërë pengesë serioze për vazhdimin në mënyrë normale të punës së këtij Komisioni, pasi sipas nenit 147/d, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 194 të Ligjit për qeverisjen, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të KLP dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë, duke përcjellë relacionin dhe dosjen pranë KLP për vendimmarrje.

Bazuar në vendimmarrjen e Komisionit të Disiplinës në mbledhjen në tij të datës 09.09.2019, Komisioni ka vendosur që të konsiderojë si pjesë të punës së tij trajtimin e kërkesave dhe ankesave të ndryshme që i kanë ardhur Këshillit nga qytetarët dhe institucionet, duke iu kthyer përgjigje sipas rastit.

Sa më sipër, duke parë edhe numrin e lartë të kërkesave, ankesave dhe denoncimeve, bazuar në nenin 24, të Ligjit Nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative, i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Këshilli i ka përcjellë këto ankesa për trajtim dhe kompetencë Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë. Ky qëndrim ka qenë i bazuar në dispozitat tranzitore, pika 5, neni 160, të Ligjit për statusin.

Duhet thënë se përveç përcjelljes për trajtim dhe kompetencë pranë Prokurorit të Përgjithshëm të këtyre kërkesë/ankesave, Komisioni i Disiplinës, ka kryer verifikimin dhe vlerësimin e pranueshmërisë në disa raste, të fakteve apo rrethanave të paraqitura në këto ankesa.

Konkretisht gjatë periudhës objekt raportimi Janar-Dhjetor 2019, Komisioni i Disiplinës ka trajtuar gjithsej, rreth 280 praktika, nga të cilat:

- 170 praktika janë arshivuar, pasi nuk plotësonin kriteret e pranueshmërisë të kërkesë/ankesave;
- 72 praktikave i është kthyer përgjigje orientuese;
- 38 praktika janë përcjellë pranë Prokurorit të Përgjithshëm për verifikim të kushteve për fillimin e hetimit disiplinor sipas nenit 160 të Ligjit për statusin;
- 3 prej praktikave të përcjella pranë Prokurorisë së Përgjithshme, janë arshivuar, për kalim të afatit 5-vjeçar të ankimit.

Gjatë periudhës së raportimit Janar – Dhjetor 2019, KLP nuk është njoftuar nga Prokurori i Përgjithshëm për asnjë rast për ndonjë vendim mbi fillimin e hetimit disiplinor ndaj ndonjë prokurori, sipas nenit 123, pika 3 të Ligjit për statusin.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, ka pasur 1 rast ku Këshilli ka marrë vendim për shkarkimin nga detyra të një prokurori për shkak të dënimit me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një krimi.

Me datë 25 Shtator 2019, përbërja e Komisionit të Disiplinës është plotësuar me dy këshilltarë ligjorë, të cilët kanë plotësuar dhe kanë mundësuar zhvillimin më me efektivitet të punës së komisionit, të cilët sikurse u përmend më sipër, përveç ndjekjes së praktikave që i janë adresuar komisionit, kanë përgatitur paraprakisht afërsisht 40 projektakte administrative që nevojiten të nxirren nga ana e Këshillit apo Komisionit gjatë procedurës disiplinore.

---

### **2.1.3 KOMISIONI I VLERËSIMIT TË VEPRIMTARISË ETIKE DHE PROFESIONALE**

Komisioni i Vlerësimit është krijuar me Vendimin Nr.6, datë 28.12.2018, “Për krijimin e komisioneve të përhershme pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, të KLP, në mbështetje të nenit 160 të Ligjit për qeverisjen.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2019, Komisioni i Vlerësimit, ka realizuar detyrat si më poshtë:

- ❖ Në lidhje me vlerësimin e punës të prokurorëve në sistemin e prokurorisë, duke përfshirë këtu edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar, që po kryhet nga institucionet e Rivlerësimit, KPK dhe KPA.

Bazuar në nenin 160 të Ligjit për qeverisjen, në nenin 184, pika dh, nenet 68 - 99 të Ligjit për statusin, Komisioni i Vlerësimit kryen vlerësimin periodik të Magjistratëve, 1 herë në 3 ose 5 vjet, sipas viteve të përvojës në profesion.

Gjatë vitit 2019, kjo veprimtari bazë nuk është ushtruar, pasi të gjithë prokurorët e Republikës janë vlerësuar më parë nga Prokuroria e Përgjithshme (organi kompetent për ligjin e kohës), përgjatë viteve 2013-2016, vite që i përkojnë kohës së rivlerësimit kalimtar të tyre.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për statusin, KLP është organi i ngarkuar për vlerësimin etik-profesional të prokurorëve, duke përfshirë këtu edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar e cila kryhet nga institucionet e rivlerësimit KPK dhe KPA.

Në bazë të nenit 160, pika 2, germa d, të këtij ligji, Prokuroria e Përgjithshme ka qenë e ngarkuar me detyrën e organit ndihmës në rivlerësimin kalimtar të prokurorëve, deri në fillimin e veprimtarisë së KLP, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe Ligjit për rivlerësimin.

Grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, në bashkëpunim me anëtarët e KPK, ka marrë pjesë në hedhjen e shortit për përzgjedhjen e pesë akteve dhe dosjeve hetimore që lidhen me këto akte, për 118 prokurorë, subjekte rivlerësimi. Nga Prokuroria e Përgjithshme janë përfunduar dhe janë dorëzuar në KPK, 83 raporte Vlerësimi të Aftësive Etike dhe Profesionale të prokurorëve në sistemin e prokurorisë, së bashku me materialet shoqëruese që kanë shërbyer për hartimin e këtyre raporteve.

Prokuroria e Përgjithshme, me krijimin e KLP dhe të Komisionit të Vlerësimit, ka përcjellë pranë KLP të gjitha materialet dhe dosjet e papërfunduara të vlerësimit etik dhe profesional për subjektet e rivlerësimit, magjistratët prokurorë.

Në këtë kontekst, një ndër detyrat kryesore të këtij Komisioni është vlerësimi i punës, si edhe përgatitja e raporteve të aftësive profesionale të prokurorëve, në kuadër të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Vlerësimi profesional i prokurorëve përfshin periudhën Tetor 2013 – Tetor 2016.

Në këtë veprimtari, për hartimin e raporteve të aftësive profesionale të prokurorëve, duke filluar nga muaji Mars i vitit 2019, komisioni është ndihmuar nga 6 prokurorë të sistemit të prokurorisë, të cilët janë komanduar të punojnë pranë KLP për një periudhë një-vjeçare me vendimin Nr.32, datë 22.02.2019 të KLP, i cili në bashkëpunim me KPK, ka organizuar shortet për përzgjedhjen në mënyrë rastësore, të pesë akteve dhe dosjeve, për shumë prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së Parë dhe të Apelit.

Pas përzgjedhjes së akteve, KLP ka administruar formularin e vetë deklarimit, 3 dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si edhe dokumente të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit. Po ashtu, janë administruar 5 dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të cilat i janë venë në dispozicion KPK dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Janë kërkuar dhe janë marrë të dhënat gjithsej nga 23 Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, Drejtoria e Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, Sektori i Protokoll-Arkivit, si dhe nga burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme, mbështetur në kriteret e përcaktuara për të kryer vlerësimin e aftësive etike dhe profesionale për magjistratët prokurorë në bashkëpunim me KPK, si:

- Aftësitë profesionale,
- Aftësitë organizative,
- Etika dhe angazhimi,

- Veprimtaria profesionale,

dhe duke u bazuar në gjetjet në aktet e administruara, janë përgatitur raportet përkatëse për analizimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit kalimtar.

Në përfundim, janë përgatitur dhe janë miratuar në seancë plenare nga ana e KLP, raporte vlerësimi profesional për subjekte prokurorë, që janë vënë në dispozicion të KPK-it dhe ONM-së.

Nga ana e KLP, vijon puna për përgatitjen e raporteve të vlerësimit profesional të prokurorëve të prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, dhe të Apelit, të shortuara nga KPK.

- ❖ Në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës, për kandidatët të cilët do të pranoheshin në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës


Detyrë tjetër e Komisionit për vitin e kaluar ka qenë ajo e verifikimit të pasurisë dhe figurës, për kandidatët të cilët do të pranoheshin në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, e parashikuar në nenin 32, të Ligjit për statusin.

KLP, nëpërmjet Komisionit ka kërkuar informacion zyrtar nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues. Konkretisht janë kërkuar informacione të detajuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës të kandidatëve.

Këshilli ka kërkuar informacion shtesë nga institucionet përgjegjëse për disa nga kandidatët, që u verifikuan me ardhjen e tyre pranë KLP. Gjithashtu, për disa kandidatë janë zhvilluar edhe seanca dëgjimore për të sqaruar çështje të ndryshme si pjesë e këtij procesi. Këtyre kandidatëve iu dha mundësia të paraqesin sqarime me shkrim si dhe kanë paraqitur dokumentacion shtesë.

Pas përfundimit të këtij procesi verifikimi, KLP mori vendim për të konsideruar të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës dhe të pranojë 20 kandidatë. Ndërsa, për 3 kandidatë të tjerë, pas përfundimit të procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, pritet të merret vendim nga ana e KLP gjatë vitit 2020.

Verifikimi i pasurisë dhe figurës për kandidatët për prokurorë të cilët përfundojnë formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës dhe në dalje të shkollës kontrollohen përsëri, ka qenë një tjetër drejtim i punës së këtij komisioni për vitin 2019. Në mbështetje të nenit 35, pika 1, germa “c”, të Ligjit për statusin, si dhe Vendimit Nr.171, datë 27.09.2019, Për miratimin e Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, të KLP, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit kanë ndjekur veprimet procedurale për verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore të kandidatëve për t’u emëruar magjistrat Prokuror, pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017-2018 dhe 2018-2019.



Raporte për analizimin e aftësive profesionale dhe etike të prokurorëve ne kuadër te rivlerësimit kalimtar

**44**

Raporte për miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit të prokurorëve

**6**

Raporteve për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatit të pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës

**13**

Rekomandime për komandimin e gjashte prokurorëve si këshilltar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë

**2**

Raporte për leje të papaguara të prokurorëve

**20**

Raporteve për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatit magjistrat të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës

**8**

- ❖ Në lidhje me punën e komisionit dhe korrespondencën e plotë me organet e vettingut, kryesisht me KPK për problematika të ndryshme që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tyre, përkundrejt rivlerësimit kalimtar të prokurorëve.

Gjatë vitit 2019, Komisioni i Vlerësimit ka kryer detyrën e tij duke patur një korrespondencë të plotë me organet e rivlerësimit kalimtar për gjyqtarë dhe prokurorë, kryesisht me KPK.

- ❖ Vendimet e rekomanduara nga Komisioni i Vlerësimit dhe të miratuara nga Këshilli, për periudhën janar -dhjetor 2019, kanë qenë si më poshtë:

- 1) Hartimi i 44 Raporteve të miratuara me vendim nga Këshilli për analizimin e aftësive profesionale dhe etike të magjistratëve, prokurorë;
- 2) Dhënia e Rekomandimeve (opinioneve) për 6 magjistratët prokuror si këshilltar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- 3) Hartimi i 13 Raporteve për miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit si magjistrat/prokuror, leje për mësimdhënie;
- 4) Hartimi i 2 Raporteve për leje të papaguara të magjistratëve të miratuara me vendim nga KLP;
- 5) Hartimi i gjithsej 20 Raporteve për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatit të pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës;
- 6) Hartimi i 8 Raporteve për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatit magjistrat të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës.

---

### 2.1.4 KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

Komisioni i Karrierës pranë KLP, në ushtrim të detyrave të tij, gjatë periudhës së raportimit Janar – Dhjetor 2019, ka realizuar kryesisht veprimtaritë si më poshtë :

1. Ka ndjekur procedurën për transferimin/komandimin/lëvizjen paralele/Caktimin e përkohshëm të prokurorëve, duke paraqitur në Këshill propozimet përkatëse;
2. Ka ndjekur procedurën dhe ka përgatitur renditjen paraprake të magjistratëve për ngritje në detyrë, duke paraqitur në Këshill propozimet përkatëse;
3. Ka ndjekur procedurën dhe ka përgatitur renditjen paraprake të magjistratëve për Drejtues Prokurorie, duke paraqitur në Këshill propozimet përkatëse;
4. Ka paraqitur në Këshill propozimet për emërimin e prokurorëve-magjistratë, ose riemërimin;
5. Ka përgatitur studimin në bazë të të cilit Këshilli miraton numrin e kandidatëve për prokurorë për t'u regjistruar në Shkollën e Magjistraturës;



6. Ka përgatitur projekt-aktet me karakter të përgjithshme ose individuale, akte nënligjore në kuadër të fushës së veprimtarisë së Komisionit, të cilët miratohen më tej nga Këshilli;
7. Ka mbajtur kontakte të rregullta me Shkollën e Magjistraturës në lidhje me trajnimin e vazhdueshëm të prokurorëve;
8. Ka ushtruar çdo kompetencë tjetër të parashikuar në ligj.

Veprimtaria e Komisionit të Karrierës ka qenë mjaft dinamike gjatë kësaj periudhe, edhe për shkak të fushës së veprimtarisë që mbulon, problematikave që janë hasur dhe nevojës për të dhënë opinione apo propozime nga ana e tij.

Objekt parësor i veprimtarisë së këtij Komisioni ka qenë vlerësimi i situatave të krijuara si rezultat i shkarkimit të Drejtuesve të Prokurorive në sistemin e Prokurorisë me vendim të organeve të Rivlerësimit, KPK-së dhe KPA-së, nëpërmjet caktimit të përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit, gjithsej në 15 raste për periudhën 1 Janar- 31 Dhjetor 2019.



Rezultojnë gjithsej 21 Prokurorë të caktuar me afat të përkohshëm për vitin 2019 nga ana e KLP dhe pothuajse për të gjithë, kemi përsëritje të emërimit, duke ruajtur në këtë mënyrë vazhdimësinë normale të punës.

***Në strukturën e sistemit prokurorial në të gjithë Shqipërinë janë të planifikuar për nevoja të sistemit në total 336 prokurorë. Ndërkohë gjendja faktike e tyre rezulton 284 prokurorë deri më datë 31.12.2019.***

Diferenca prej 52 prokurorësh tregon vakanca në sistem që kanë ardhur për disa arsye, ndër më kryesoret dhe që kanë ndikuar dukshëm në pengimin e punës së prokurorive është largimi si rezultat i rivlerësimit kalimtar të magjistratëve prokuror nga organet e KPK dhe KPA.

***Nga një analizë e detajuar e shpërndarjes së burimeve njerëzore (Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit dhe Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë), për periudhën 01 Janar – 31 Dhjetor 2019, rezulton grafikisht situata si më poshtë:***

## Raport Vjetor 2019




### Shënim:

***Në tablën e gjendjes aktuale të burimeve njerëzore në sistemin prokurorial nuk janë përfshirë:***

- Gjashtë emërimet e prokurorëve si anëtarë të KLP.
- Gjashtë komandimet e prokurorëve si këshilltarë në KLP.

Në gjithë territorin e vendit funksionojnë 29 Zyra të Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit dhe të Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë.

Gjatë vitit 2019 janë caktuar apo emëruar me vendim të Këshillit si më poshtë:



- 15 prokurorë janë të caktuar përkohësisht si Drejtues Prokurorie, përkatësisht 10 Drejtues në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe 5 Drejtues në Prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit;
- 7 prokurorë rezultojnë të caktuar përkohësisht në pozicione të ndryshme, në të gjitha shkallët e Prokurorisë me vendim të KLP.
- 7 magistratë janë emëruar dhe caktuar në pozicion në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, 3 prej të cilëve të rikthyer rishtaz në sistem.

Gjithashtu, KLP, në përputhje me nenin 53/2, të Ligjit për statusin dhe nenin 176/3, të Ligjit për qeverisjen, ftoi të gjithë prokurorët që nuk ishin të komanduar në ndonjë pozicion tjetër, të shprehnin interesin për t'u komanduar në pozicionin e Këshilltarit pranë KLP-së. Në përputhje me procedurat ligjore, fillimisht për vitin 2019 janë.

Në rastin e caktimeve të përkohshme, KLP është treguar shumë i kujdesshëm në zbatimin e nenit 59, të Ligjit për statusin, duke e zbatuar këtë dispozitë vetëm në ato raste, kur caktimi i përkohshëm i një prokurori në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë, apo të prokurorit të juridiksionit të përgjithshëm apo në nivel apeli, ka qenë domosdoshmëri. Për rrjedhojë, Vendimet e KLP për caktimin e përkohshëm të prokurorëve kanë ardhur si rezultat i një vendimmarrje të organeve të Rivlerësimit, KPK apo KPA, dhe krijimit të vendeve të lira përkohësisht.

Emërimi dhe caktimi në detyrë i magistratëve prokurorë që kanë përfunduar Shkollën e

Magjistraturës, është një nga detyrimet që ka KLP. Gjatë vitit 2019, janë emëruar dhe caktuar në pozicion gjithsej 6 magjistratë të rinj. Sipas procedurës ligjore është bërë shpallja e vakancave për magjistratët, marrja e pëlqimeve, e më pas emërimi dhe caktimi i tyre në detyrë. Një prokuror është emëruar me vendim të Gjykatës Administrative të Apelit.

KLP, ka miratuar me Vendim, 9 propozime të paraqitura nga Komisioni i Karrierës së KLP, për mbarimin e statusit të magjistratit, ndër të cilat tre janë kërkesa për dorëheqje, katër janë mbarim i statusit për shkak të plotësimit të moshës për daljen në pension dhe dy janë rastet e mbarimit të statusit të dy anëtarëve të KLP, për shkak të papajtueshmërisë në ushtrimin e detyrës.

Gjithashtu, Komisioni i Karrierës, në ushtrim të kompetencave të tij, ka pasur në fokus të veçantë, krijimin e Prokurorisë së Posaçme, si një prej detyrimeve ligjore më të rëndësishme të vitit që lamë pas, për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në vëmendje jo vetëm të institucioneve ligj zbatuese në vend, por edhe të faktorit ndërkombëtar.

## 2.2 KOMISIONET E POSAÇME

### 2.2.1 NGRITJA DHE PËRBËRJA E KOMISIONIT TË POSAÇËM

Sipas nenit 11 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”, Komisioni i Posaçëm përbëhet nga 5 anëtarë të KLP, prej të cilëve 3 anëtarë prokurorë dhe 2 anëtarë joprokurorë.

Anëtarët e Komisionit të Karrierës janë exofficio anëtarë të Komisionit të Posaçëm. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit përjashtohen exofficio nga pjesëmarrja në Komisionin e Posaçëm.

Dy anëtarët e tjerë të Komisionit të Posaçëm, njëri prej të cilëve anëtar prokuror dhe tjetri anëtar joprokuror, zgjidhen me short nga pjesa e mbetur e anëtarëve të Këshillit.

Në momentin e miratimit të rregullores, për shkak të shkarkimit nga detyra e anëtarës së Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, znj. Antoneta Sevdari, ky Komision kishte dy anëtarëz. Sandër Beci (joprokuror) dhe z. Arben Dollapaj (prokuror). Duke qenë se anëtari i ri i KLP ende nuk ishte zgjedhur, anëtar zëvendësues i Komisionit të Posaçëm do të ishte, z. Bujar Sheshi (prokuror).

Për shkak të parashikimeve si më sipër në nenin 11 të rregullores, anëtari i tretë prokuror i Komisionit të Posaçëm, automatikisht do të ishte z. Besnik Cani i cili nuk kishte ndalim për të qenë në këtë Komision.

Anëtari i pestë (joprokuror) i Komisionit do të caktohej me short mes antarëve të mbetur që nuk kishin ndalim për të qenë anëtar. Shorti është hedhur mes anëtarëve:

- Gent Ibrahim
- Nurihan Seitaj
- Tartar Bazaj.

Pas zhvillimit publik të shortit, anëtar i Komisionit të Posaçëm u caktua z. Tartar Bazaj. Përbërja e Komisionit të Posaçëm, caktuar sipas kriterëve dhe procedurës së mësipërme është:

1. Arben Dollapaj – prokuror
2. Besnik Cani – prokuror
3. Bujar Sheshi – prokuror
4. Sandër Beci – jo prokuror
5. Tartar Bazaj – jo prokuror

Me urdhër nr. 56, datë 02.04.2018, të Kryetarit të KLP, z. Sandër Beci u caktua Kryetar i Komisionit të Posaçëm.

---

### 2.2.2 VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË POSAÇËM

Me krijimin e Komisionit të Posaçëm, nis veprimtaria e tij me procesin e verifikimit të plotësisimit të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve të cilët kishin aplikuar për ngritjen në detyrë si prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme.

Në datën 04.04.2019, Komisioni i Posaçëm u mbledh në mbledhjen e tij të parë, pas hyrjes në fuqi të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar”.

Sipas nenit 3, pika 1 të kësaj Rregulloreje, Komisioni në këtë mbledhje kreu vlerësimin paraprak të të gjithë kandidatëve për të përcaktuar nëse ata i plotësojnë kushtet ligjore për ngritjen në detyrë si prokuror në Prokurorinë e Posaçme.

Pranë Këshillit erdhën 28 aplikime sipas njoftimit të bërë në faqen zyrtare të tij, më datë 07.01.2019.

Komisioni shqyrtoi secilin prej aplikimeve dhe verifikoi kushtet ligjore.

Pas verifikimit paraprak, Komisioni vlerësoi se 25 kandidatë plotësojnë kushtet ligjore dhe mund të vazhdojnë procesin e vlerësimit të kriterëve të posaçme etike dhe profesionale.

Këshilli, në mbledhjen e tij të datës 05.04.2019, mori në shqyrtim raportin e Komisionit të Posaçëm dhe me vendim nr. 57, datë 05.04.2019 miratoi listën me 25 kandidatët, që plotësonin kushtet ligjore dhe mund të vijohej më vlerësimin e kriterëve profesionale dhe etike të tyre. Lista pësoi ndryshime në vijim, pasi një prej kandidatëve u zgjodh anëtar i KLP dhe detyra e re ishte e papajtueshme me atë të prokurorit, gjatë kohës së ushtrimit të

mandatit, një kandidat paraqiti dorëheqjen përpara Këshillit, si dhe një kandidat u shkarkua nga KPK më datë 26.06.2019 dhe për këtë shkak, u pezullua nga detyra si prokuror.

Komisioni i Posaçëm vendosi një komunikim zyrtar me kandidatët e shpallur nga KLP, duke u dërguar një shkresë zyrtare për të identifikuar punën e tyre në përputhje me rregulloren sipas parashikimeve të nenit 11, pika 1 sipas të cilit *“Komisioni kërkon nga kandidatët të identifikojnë produktin e punës së tyre dhe çështjet që mbështesin aplikimin e tyre, në përputhje me kriteret e renditura në nenin 9. Kandidatët kanë 7 ditë kohë afat kohor për të identifikuar këto dokumente dhe për t'i vënë në dispozicion të Komisionit”*

Nga ana e kandidatëve është kërkuar të vënë në dispozicion të Komisionit:

- Dosje ku të dokumentohet hetimi me sukses i çështjeve penale të ndërlikuara ligjërisht ose në fakte, përfshi përdorimin e metodave të avancuara të hetimit dhe qasjen proaktive ose,
- Vendime gjykate në të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash ose për çështje të tjera të ndërlikuara dhe ku të dokumentohet fakti që keni qenë drejtues grupi hetimor ose prokuror i vetëm dhe/ose keni përfaqësuar prokurorinë në nivel apeli/Gjykatë të Lartë ose,
- Vendime gjykate në të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash ose për çështje të tjera të ndërlikuara dhe ku të dokumentohet fakti se keni qenë pjesë e një grupi prokurorësh në shkallë të parë ose në apel ose,
- Vendime gjykate, kërkesa për konfiskim ose çdo akt tjetër që dokumenton kërkimin me sukses nga ana juaj të konfiskimit të pasurive që janë produkte të veprës penale ose të pasurive në zbatim të ligjit antimafia.

---

### 2.2.3 TAKIMI ME KANDIDATËT DHE ÇËSHTJET E DISKUTUARA

Komisionit kërkoi zyrtarisht takim me kandidatët për të sqaruar procedurat e mëtejshme. Takimi u fokusua kryesisht tek sqarimet lidhur me rregulloren dhe dokumentacionin që duhet të paraqisnin kandidatët në vijim. Nga ana e të gjithë anëtarëve të komisionit u sqarua procesi i vlerësimit të tyre dhe u kërkuan të vihen në dispozicion brenda afatit të përcaktuar në rregullore akte të procedimeve të ndryshme penale që do të dëshmonin kualifikimin e prokurorëve. Nga ana e prokurorëve kandidatë u kërkua edhe një javë shtesë për paraqitjen e dokumentacionit, kërkesë që u miratua nga ana e komisionit.

Nga disa kandidatë u shtrua për diskutim çështja nëse mund të sillnim për vlerësim akte të dosjeve që janë në hetim. Nga ana e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit u sqarua edhe njëherë fryma e rregullores e cila vlerësimin e bazon në çështje të përfunduara, ku aftësitë dhe kualifikimi i prokurorëve lidhet me faktin që kemi vendime gjykate (edhe të shkallës

së parë). Në përfundim të takimit u kërkua që kandidatët të mos sjellin për vlerësim akte të dosjeve të cilat janë ende në hetim.

Gjithashtu u përsërit edhe njëherë ndalimi që buron nga rregullorja, konkretisht nga neni 21 i saj lidhur me komunikimet jozyrtare mes kandidatëve dhe anëtarëve të Komisionit/Këshillit. Për këtë arsye u kërkua që kandidatët t'i paraqesin dokumentet e kërkuara në mënyrë zyrtare.

Nga ana e komisionit iu kërkua kandidatëve të shpreheshin për konfliktin e interesave mes tyre dhe anëtarëve të komisionit dhe këshillit si trupa që do të bënin vlerësimin e tyre. Gjithashtu u vunë dukje fakti që Komisioni mund të kërkonte prej tyre sqarime ose dokumentacion shtesë. Për këtë qëllim Komisioni krijoi një adresë zyrtare dedikuar komunikimeve me kandidatët. Adresa e Komisionit: [komisioniposacem@klp.al](mailto:komisioniposacem@klp.al).

---

### 2.2.4 METODOLOGJIA E PËRDORUR NGA KOMISIONI

Pas dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar nga kandidatët, Komisioni filloi punën për vlerësimin e tyre sipas kriterëve të parashikuara në nenin 9 dhe 10 të rregullores. Së pari Kryetari i Komisionit të Posaçëm miratoi me Urdhër, metodologjinë e punës së tij. Kjo metodologji përcaktonte miratimin e tabelave të vlerësimit paraprak të kandidatëve nga ana e anëtarëve të komisionit, shortin për përpunimin fillestar të dokumentacionit dhe vlerësimin paraprak, tërheqjen e dokumentacionit të kandidatëve pranë protokollit të KPL, rishikimin e vlerësimit të parë të kryer nga një relator, rihedhjen e një shorti të dytë dhe qarkullimin e dokumentacionit dhe raporteve paraprake të të gjithë anëtarët e Komisionit.

Gjithashtu kjo metodologji përcaktonte edhe mënyrën e raportimit në Këshill, monitorimin e procesit të vlerësimit nga ana e misionëve ndërkombëtare OPDAT dhe EURALIUS si dhe pjesëmarrjen e Kryetarit të Këshillit apo një përfaqësuesi të tij në mbledhjet e Komisionit.

Sipas kësaj metodologjie, mbledhjet mund të regjistroheshin audio dhe për to të mbahej një procesverbal.

Në vijim komisioni i propozoi Këshillit, shkallët e vlerësimit për secilin kandidat dhe për secilin kriter të parashikuar në Rregullore.

### 2.2.5 VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR I KOMISIONIT

Pas një pune intensive dhe diskutime të gjata, Komisioni vlerësoi se nga 22 kandidatët në garë për prokurorë, pas procesit të intervistimit të zhvilluar gjatë muajit korrik 2019, duhet të përzgjidheshin 15 kandidatë për prokurorë pranë SPAK, sipas kritereve të parashikuara në nenin 9 dhe 10 të rregullores.

Me vendim nr. 137, datë 16.7.2019, KLP miratoi listën me renditjen e kandidatëve për prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme, listë kjo e njohur tashmë edhe për publikun e gjerë.

Në këtë fazë, komisioni konstatoi se 8 prokurorë, kandidatë për Prokurorinë e Posaçme kanë kaluar me vendim të formës së prerë procesin e rivlerësimit duke u konfirmuar në detyrë dhe duke përmbushur një nga kushtet ligjore për të qenë prokuror pranë kësaj prokurorie.

Në kushtet aktuale, duke rikonfirmuar vullnetin për të zbatuar vendimmarrjen e mëhershme të Këshillit për të emëruar 15 prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, si dhe duke pasur parasysh që, procesi i rivlerësimit për disa nga kandidatët për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme është në faza të ndryshme të tij.

Njëkohësisht duke vlerësuar që ky proces është i pavarur nga vendimmarrja e Këshillit dhe kohëzgjatja e tij është e pamundur për t'u përllogaritur dhe duke u nisur nga pritshmëritë e opinionit publik dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë,

Komisioni i Posaçëm i propozoi Këshillit të Lartë të Prokurorisë që, brenda 30 ditëve, Këshilli, në mbledhje plenare, të përmbyllë procedurën e ngritjes në detyrë për 8 prokurorë kandidatë për Prokurorinë e Posaçme dhe të kryhet emërimi i tyre pranë kësaj prokurorie.

Gjithashtu, komisioni i propozoi Këshillit që të autorizonte Kryetarin e KLP për të koordinuar punën me Këshillin e Lartë Gjyqësor për të marrë në mënyrë të njëkohshme vendimet përkatëse për Gjykatën e Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Njëkohësisht, komisioni i propozoi Këshillit që të autorizonte Kryetarin e KLP për të koordinuar punën me Prokurorin e Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë për të rishpërndarë në prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, vendet që krijohen pas pushimit të funksionimit të Prokurorisë për Krime të Rënda.

Së fundi, Komisioni i propozoi Këshillit që të autorizonte Komisionin e Posaçëm për të vendosur kontaktet me kancelarët e Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe nëpërmjet tyre me administratën e këtyre prokurorive, që deri në krijimin e Komisionit të Ristrukturimit sipas nenit 86 pika 6 të Ligjit për prokurorinë, të sigurojnë marrjen e pëlqimit nga nëpunësit e administratës së Prokurorisë për Krime të Rënda që do qëndrojnë në Prokurorinë e Posaçme dhe plotësimin prej tyre të kushteve të sigurisë sipas ligjit.



## 2.3 KOMISIONET E TJERA (KOMISIONI PËR MBROJTJEN E PROKURORËVE)

### 2.3.1 NGRITJA E KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E PROKURORËVE

Komisioni për Mbrojtjen e Prokurorëve zhvillon veprimtarinë e vetë mbështetur në Nenin 20, të Ligjit për statusin dhe në VKM Nr. 564, datë 31.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e veçantë të magjistratëve gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij”.

Me anë të Vendimit Nr. 163, datë 16.09.2019, të Këshillit “Për caktimin e anëtarit të komisionit për mbrojtjen e prokurorëve”, KLP ka caktuar z. Tartar Bazaj si anëtar të këtij komisioni. Për shkak të VKM nr.564, datë 31.07.2019, z. Bazaj është njëkohësisht edhe kryetar i këtij komisioni. Anëtarët e tjerë janë përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Prokuroria (prokuroria ku ushtron funksionin magjistrati i cili kërkon mbrojtje të veçantë) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

### 2.3.2 VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E PROKURORËVE

Veprimtaria e Komisioni për Mbrojtjen e Prokurorëve për vitin 2019 ka qenë relativisht e kufizuar në vendime për dhënien e mbrojtjes së veçantë prokurorëve kërkuar, për shkak të fushës së veprimtarisë që mbulon, si dhe rasteve të pakta për të dhënë mbrojtje të veçantë gjatë vitit 2019.

Po kështu, objekt i veprimtarisë së këtij Komisioni ka qenë vlerësimi i kërkesave të prokurorëve për mbrojtje të veçantë fizike për shkak të kërcënimit faktik të tyre nga persona me rrezikshmëri të lartë, persona nën hetim apo të dënuar me burgime të gjata.

Nga një analizë e gjendjes në lidhje me dhënien e mbrojtjes së veçantë për prokurorët e kërcënuar referuar kërkesave të tyre për vitin 2019, rezulton situata si më poshtë:

Janë paraqitur para Komisionit 5 (pesë) kërkesa për mbrojtje të veçantë nga prokurorë dhe janë dhënë nga Komisioni 5 vendime për miratimin e kërkesës për mbrojtje të veçantë të prokurorit në prokurori të ndryshme të vendit. Në vendime janë evidentuar prania e rrethanave serioze që rrezikojnë jetën, familjen dhe pasurinë e prokurorit kërkuar si dhe prania e lidhjes shkakësore ndërmjet rrethanave serioze në ushtrimin e detyrës.

### 2.3.3 MARRËDHËNIET E KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E PROKURORËVE ME INSTITUCIONET E TJERA

Komisioni ka pasur komunikim të vazhdueshëm me institucionet e ngarkuar nga ligji, me detyra konkrete në mbrojtjen e prokurorëve të kërcënuar. Vendimi i Komisionit për dhënien e mbrojtjes së veçantë i është përcjellë menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me qëllim realizimin në kohë të mbrojtjes së veçantë të prokurorëve.

Janë njoftuar menjëherë lidhur me vendimet e marra drejtuesit e prokurorive përkatëse ku ushtrojnë detyrën prokurorët kërkues, të cilët kanë kërkuar mbrojtje të veçantë gjatë ushtrimit të detyrës.

## 3. VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE DHE FINANCIARE E KËSHILLIT

### 3.1 ORGANIZIMI I ADMINISTRATËS SË KLP

Kuvendi i Shqipërisë me Vendimin nr. 33/2019, dt. 26.02.2019 ka miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të administratës së KLP duke përcaktuar gjithsej 65 (gjashtëdhjetë e pesë) punonjës edhe pse nevojat për punonjës të propozuara më parë nga KLP ishin më të larta.

Pas miratimit të numrit të punonjësve të KLP nga Kuvendi, me Vendimin nr. 36, dt. 06 mars 2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, KLP ka miratuar strukturën organizative të administratës së tij, në përputhje me nenin 178, të Ligjit për qeverisjen ku janë përcaktuar qartë mënyra e organizimit dhe njësitë mbështetëse të administratës së KLP.

Si Kuvendi i Shqipërisë ashtu dhe KLP, në përcaktimin e numrit dhe të strukturës së administratës së KLP-së, kanë vlerësuar si faktor kryesor mundësitë aktuale për realizimin e misionit dhe të funksioneve kryesore që KLP duhet të përmbushë në zbatim të Kushtetutës, të Ligjit për qeverisjen dhe akteve të tjera ligjore.

Nga pikëpamja administrative, KLP është i organizuar si më poshtë:

**Kryetari:** Drejton dhe organizon veprimtarinë e administratës së KLP-se, në zbatim të Ligjit për qeverisjen dhe asistohet nga një Ndihmës-asistent në kryerjen e detyrave administrative duke garantuar zhvillimin normal të veprimtarisë administrative të Kryetarit.

**Zv/Kryetari:** Në mungesë të Kryetarit ai kryen të gjitha funksionet e Kryetarit si dhe merr përsipër detyra të caktuara e të autorizuara nga Kryetari për një efikasitet më të madhe në realizimin e objektivave.

**Anëtarët:** KLP është organ kolegjal i cili përbëhet nga 11 anëtarë (ku përfshihen Kryetari dhe Zv/Kryetari), nga të cilët 6 anëtarë janë prokurorë të të gjitha niveleve ndërsa

5 anëtarë vijnë nga fusha e avokatisë, trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës dhe shoqëria civile. Anëtarët e KLP ushtrojnë funksionet e tyre në Mbledhje Plenare ose në Komisionet e Përhershme të KLP, sipas parashikimeve ligjore.

**Këshilltari për Etikën:** Ashtu siç përcaktohet dhe në nenin 182 të Ligjit për qeverisjen, Këshilltari për Etikën zgjidhet nga radhët e prokurorëve dhe mbulon çështjet e etikës së prokurorëve, angazhohet në hartimin e rregullores së etikës për sistemin e prokurorisë, mund të kërkojë mendimin e KLP për çështje të caktuara që kanë të bëjnë me sjelljen e prokurorëve. Ka detyrën dhe përgjegjësinë për hartimin, publikimin dhe përditësimin vazhdimisht të manualit informues, i cili përmban pyetje dhe përgjigje mbi dilemat etike, bazuar në standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare dhe vendimet relevante të KLP. Kujdeset, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm mbi çështje të etikës. Raporton me shkrim, jo më pak se një herë në vit, përpara KLP lidhur me veprimtarinë e tij. Këshilltari për Etikën është në varësinë e drejtëpërdrejtë të Kryetarit dhe në bashkëpunim të ngushtë me të pasi detyrat që ai mbulon kryesisht kanë karakter rregullator dhe kërkojnë në përgjithësi miratime dhe shqyrtime nga KLP.

**Kabineti:** Kabineti është i përbërë nga drejtori, tre këshilltarë dhe një asistent i Kryetarit. Kabineti është strukturë organizative që funksionon pranë Kryetarit në varësi direkte të tij. Ai luan një rol të rëndësishëm konsultativ dhe verifikues për problemet dhe fushën e përgjegjësisë që mbulon Kryetari dhe në përgjithësi institucioni, si dhe shërben si strukturë filtruese e çështjeve administrative.


**Sekretari i Përgjithshëm:** Ashtu sikurse përcaktohet në nenin 177, të Ligjit për qeverisjen, Sekretari i Përgjithshëm i KLP është nëpunësi më i lartë civil dhe drejtuesi më i lartë administrativ. Sekretari i Përgjithshëm varet drejtëpërdrejtë nga Kryetari.

**Departamenti i Shërbimeve Ligjore:** Departamenti i Shërbimeve Ligjore konsiderohet departamenti më i rëndësishëm në strukturën administrative të institucionit. Ky departament mbulon detyrat kryesore që KLP ka në realizimin e misionit të tij, siç janë shërbimet plenare, hartimi i dokumenteve dhe akteve nënligjore si dhe rregullore të ndryshme të domosdoshme për mirëfunksionimin e strukturave, mbështet dhe koordinon punën me Komisionet e Përhershme të KLP, etj. Ky departament është i organizuar me dy drejtori/njësi: **Njësia e Mbështetjes së Komisioneve dhe Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme Ligjore**, të cilat përbëhen nga drejtuesit si dhe këshilltarët. Në mënyrë të veçantë, Njësia e Mbështetjes së Komisioneve ka varësi të dyfishtë administrative dhe funksionale qoftë nga ky departament ashtu edhe nga Komisionet e Përhershme të KLP.

**Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse:** Siguron mbarëvajtjen e punës së institucionit, duke siguruar të gjithë shërbimet mbështetëse, administrimin financiar, të burimeve njerëzore, të mirëmbajtjes, mbështetjen me anë të strukturave TIK (teknologjinë e informacionit) magazinimit, transportit dhe pastrimit. Kjo drejtori e përgjithshme është e organizuar në dy drejtori: **Drejtorja Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore** e cila ka në varësi të saj dy sektorë: Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori

i Financës, si dhe Drejtoria e Shërbimeve të Mirëmbajtjes e cila ka në varësi dy sektorë: Sektori i Shërbimeve Administrative dhe Sektori i Administratës.

## STRUKTURA KLP



### 3.2 PROCESI I REKRUTIMIT TË NËPUNËSVE CIVILË DHE PUNONJËSVE TË KLP

Siç u tha më sipër në pikë 3.1, pas miratimit të numrit të përgjithshëm të punonjësve nga ana e Kuvendit, KLP ka miratuar strukturën organizative si dhe ka filluar procedurat e rekrutimit të nëpunësve civilë/punonjësve të Këshillit.

Në zbatim të Ligjit për qeverisjen, parashikohet se ligji për nëpunësin civil zbatohet mbi personelin e KLP, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Në këto kushte, procedurat e rekrutimit të nëpunësve të KLP janë kryer duke marrë parasysh Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, VKM nr. 242 “Për

plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 243 datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar.

Për plotësimin e vendeve të lira në Shërbimin Civil u përdorën këto procedura rekrutimi:

1. Lëvizje paralele brenda së njëjtës kategori;
2. Ngritje në detyrë;
3. Pranim nga jashtë shërbimit civil.

Numri dhe pozicionet e nëpunësve civilë të rekrutuar deri në muajin dhjetor 2019 rezulton të jetë: 19 nëpunës civilë nga 32 në total të parashikuar në strukturën e KLP.

Duhet theksuar se në Njësinë e Mbështetjes së Komisioneve, në Departamentin e Shërbimeve Ligjore janë komanduar përmes procedurës së komandimit të parashikuar në Ligjin për Statusin, për një periudhë një vjeçare, 6 (gjashtë) Prokurorë, në pozicionin e këshilltarit.

Qëllimi në realizimin e procedurave të rekrutimit ka qenë dhe do të mbetet pranimi i stafit me integritet të lartë profesional dhe eficient.

Sa i përket procedurës së rekrutimit të punonjësve të KLP, të cilët nuk janë pjesë e Shërbimit Civil, këta të fundit janë rekrutuar në bazë të Kodit të Punës, dhe kanë filluar marrëdhënien juridike të punës pas nënshkrimit të kontratës 1-vjeçare, me të drejtë rinovimi, me KLP.

Deri më datë 31.12.2019 janë emëruar 9 punonjës nga 10 në total të parashikuar në strukturën e KLP.



### 3.3 KRIJIMI I DATABASE ME TË DHËNAT E PROKURORËVE NË RSH

Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë KLP është përgjegjëse për të mbajtur dosjet personale dhe të dhënat për çdo prokuror të Republikës së Shqipërisë.

Të dhënat e prokurorëve janë mbajtur manualisht dhe fizikisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, përpara krijimit të KLP.

Pas ndryshimeve ligjore dhe krijimit të KLP, ky institucion, përveçse garanton statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, ka në ngarkim edhe mbajtjen e të dhënave dhe dosjeve personale të prokurorëve.

Për këtë, në bashkëpunim me ekspertët e angazhuar pranë EURALIUS, të cilët ofrojnë asistencë teknike për KLP, u mundësua krijimi i një databaze me të dhënat e prokurorëve në R.SH i quajtur M-Files (Sistemi i të dhënave të Magjistratëve).

Ky program mundëson:

- Digjitalizimin e dosjeve personale të prokurorëve të R.SH në format elektronik në programin M-File për menaxhimin e dokumentacionit.
- Krijon raporte statistikore automatike të cilat kanë mundësinë të tregojnë një panoramë më të gjerë të dosjeve personale për analiza dhe krahasime të ndryshme.
- Ndhmon dhe lehtëson punën e përditshme të Komisionit të Karrierës së KLP dhe të stafit të Burimeve Njerëzore.
- T'i japë më shumë lehtësi, vizibilitet dhe kontroll përdoruesve të informacionit.
- Ky program e konsolidon informacionin në një vend të vetëm duke ofruar eficiencë dhe automatizim në përpunimin e të dhënave të prokurorëve, në lidhje me karrierën e tyre.
- Redukton punën manuale të punonjësve të Burimeve Njerëzore, duke e fokusuar veprimtarinë e tyre në çështje analitike.
- Gjeneron automatikisht të dhëna statistikore për dosjen personale të prokurorëve, si dhe të dhëna përmbledhëse për të gjithë prokurorët.
- Ndhmon në ruajtjen e këtyre dosjeve në mënyrë digjitale.

Në bashkëpunim me ekspertët e EURALIUS filloi përshtatja e programit sipas kërkesave të legjislacionit dhe filloi të implementohet në fillim të vitit 2019 me hedhjen e dosjeve personale të prokurorëve, për të krijuar databazën.

Aktualisht janë hedhur në program **330** dosje personale me informacion të detajuar për secilin prokuror, ku përfshihen të dhëna me karakter personal, me karakter ligjor lidhur me gjendjen gjyqësore, apo të gjendjes shëndetësore.

Njëkohësisht, pjesë e këtyre dosjeve janë të dhëna mbi arsimimin dhe mbi karrierën e prokurorëve.

## Raport Vjetor 2019

Pas hedhjes edhe përditësimit të dokumentacioneve për secilin prokuror, ky program gjeneron disa raporte statistikore, mbi rivlerësimin kalimtar të prokurorëve, mbi vjetërsinë në punë, mbi zhvillimin e karrierës si dhe të dhëna të tjera me karakter të përgjithshëm.

### 3.4 ANALIZA FINANCIARE DHE BUXHETI

Buxheti vjetor i KLP është miratuar në përputhje me *Ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”*, i ndryshuar, si dhe me aktet nënligjore si: VKM nr. 343, datë 02.05.2019, “Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve dhe të fondeve buxhetore për institucionet e sistemit të drejtësisë për vitin 2019”; Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, dhe Udhëzimi plotësues nr. 1, datë 17.01.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, i ndryshuar.

Burimi kryesor i financimit të KLP është buxheti i shtetit.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk gjeneron të ardhura të tjera.

Ky ligj ka miratuar buxhetin vjetor për periudhën qershor - dhjetor 2019:

Entiteti	Kod.	Emër Institucioni	Kapitull	Llogaria	Kodi i	DEBITI	Emërtimi Projektit
					Qarkut		
1	1035001	KLP	1	6000000	3535	60 000	Paga
1	1035001	KLP	1	6010000	3535	8000	Sigurime shoqërore
1	1035001	KLP	1	6020000	3535	20000	Shërbime
1	1035001	KLP	1	2310000	3535	20000	Investime
Totali						<b>108000</b>	


Gjatë vitit 2019 plani buxhetor dhe faktik ka qenë si më poshtë;

Nr.	ZËRAT E SHPENZIMEVE	QERSHOR - DHJETOR 2019		
		PLAN	FAKT	REALIZIMI %
		Në 000/lekë		
1	<i>Paga</i>	<b>60 000</b>	<b>32 349</b>	<b>54%</b>
2	<i>Sigurime Shoqërore</i>	<b>8 000</b>	<b>31 58</b>	<b>39%</b>

## Raport Vjetor 2019

3	<i>Mallra dhe Shërbime</i>	20 000	17 858	89%
4	<i>Investime</i>	20 000	10 500	53%
	<i>Totali</i>	108 000	63 865	59%

Pesha specifike në buxhetin vjetor të shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik (fakti)



Nga pasqyra e mësipërme rezulton se, buxheti për periudhën qershor-dhjetor 2019 është realizuar në masën 59%, i ndarë si më poshtë:

1. Paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore (600+601) realizuar 46.5%, kjo për faktin se deri në fund të vitit 2019 struktura e KLP ka pasur 43 punonjës.
2. Shpenzimet operative (602) realizuar 89%. Realizimi i këtij zëri vjen si rezultat i kompletimit të një pjese të stafit mbështetës, duke ndikuar në realizimin e procedurave të prokurimit për mallra dhe shërbime të nevojshme për mirëfunksionimin e institucionit. Niveli i realizimit të këtij zëri është i tillë, pasi është ekzekutuar vendimi gjyqësor nr. 4201, datë 12.12.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, për pagesën e magjistratëve, kandidatë për prokurorë, gjë që zë një peshë të madhe specifike.
3. Investimet publike (231) janë realizuar 53% e fondit të planifikuar. Për vitin 2019, u planifikuan në 2 projekte:- blerje automjete dhe - blerje pajisje TIK. Nga këto dy projekte u realizua vetëm njëri prej tyre, blerja e 3 automjeteve për KLP. Mosrealizimi i projektit të dytë vjen si pasojë e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë, ku u ndalua nënshkrimi i kontratave të reja në proces prokurimi apo procedura prokurimi të reja të ndërmarra me fonde publike, për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të institucionit dhe të paparashikueshme, forca madhore, (tërmeti), në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit.



## Raport Vjetor 2019


Bazuar në Ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, KLP i janë miratuar fondet buxhetore si më poshtë:

000/lekë

Entiteti	Kod.	Emër Institucioni	Kapitull	Llogaria	Kodi i	DEBITI	Emërtimi Projektit
					Qarkut		
1	1035001	KLP	1	6000000	3535	100 000	Paga
1	1035001	KLP	1	6010000	3535	13 241	Sigurime shoqërore
1	1035001	KLP	1	6020000	3535	22 083	Shërbime
1	1035001	KLP	1	2310000	3535	17 000	Investime
Totali						152 324	

### 3.5 PROCESET GJYQËSORE

KLP gjatë vitit 2019 ka qenë palë në gjykim në disa çështje me tipologji të ndryshme. Deri në muajin shtator 2019, nuk ka qenë e ngritur ende Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme Ligjore, që ka për kompetencë të ndjekë proceset gjyqësore. Ndaj, për këtë periudhë proceset janë ndjekur nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve të KLP. Gjithsej janë ndjekur 5 procese si më poshtë:



- Kërkesë-Padi e ngritur nga një Prokuror për shfuqizim të Vendimit të Këshillit, në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë. Për këtë çështje është vendosur moskompetencë funksionale (referuar kërkesës sonë) dhe kalim i akteve në KPA dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.
- Kërkesë-Padi e ngritur nga Magjistratë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, me objekt Trajtim Financiar. Nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, për këtë çështje është vendosur pranimiti i padisë. Nga ana e Këshillit është paraqitur ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.
- Kërkesë-Padi e ngritur nga njëri prej kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm, me objekt anulimin e procedurës së zgjedhjes së Prokurorit të Përgjithshëm. Nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, për këtë çështje është vendosur rrëzimi i padisë dhe lënia në fuqi e Vendimit të Këshillit.
- Kërkesë-Padi e ngritur nga Prokuroria e Përgjithshme ndaj një Zyre Përmbarimore, me objekt Kundërshtim veprimesh përmbarimore. Në këtë proces KLP është thirrur si palë e tretë e interesuar. Nga ana e Gjykatës është vendosur rrëzimi i padisë.
- Kërkesë-Padi të shqyrtuar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë ku Këshilli ka hyrë si palë, duke zëvendësuar Presidentin e Republikës. Gjykata ka lënë në fuqi Vendimin e Shkallës së Parë. Këshilli, në zbatim të vendimit të Gjykatës ka emëruar Prokuror paditësin.

## 4 MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE TË KËSHILLIT

### 4.1 MARRËDHËNIET E KLP ME SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

Emërimi dhe caktimi në detyrë i magjistratëve prokurorë që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, është një nga detyrimet që ka KLP. Kjo procedurë është parashikuar në Ligjin për statusin.

Në korrik të vitit 2018, kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, brezi i studentëve, të cilët nuk janë të emëruar dhe caktuar në prokurori. Nisur nga detyrimi, por dhe nga nevoja që ka emërimi i tyre, KLP menjëherë, në mbledhjen e tij të tretë më datë 07.01.2019<sup>22</sup>, vendosi të fillojë procesin e emërimit të kandidatëve për magjistratë, të cilët janë diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2016, duke kërkuar nga institucionet kompetente raportim për verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidatëve, siç parashikohet në nenin 32, pika 2 e Ligjit për statusin.

Emërimi përfundimtar i magjistratëve do të plotësonte një pjesë të vakancave në prokurori, të cilat kanë ardhur si pasojë e largimeve prej procesit të Vettingut, mbushjes së moshës së pensionit të disa prokurorëve, dorëheqjes, etj. Në përfundim të procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës për 6 magjistratë të profilit prokurorë, KLP i emëroi në

---

22 Vendim nr.10, datë 07.01.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

detyrë në datë 12.07.2019.

KLP ka kryer verifikimet për 10 magjistratë të profilit prokurorë, të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe emërimi i tyre është prioritet i punës për fillimin e vitit 2020.

Paralelisht, është kryer verifikimi i pasurisë dhe të figurës së 20 kandidatëve që konkurojnë për t'u pranuar në Shkollën e Magjistraturës. Për tre kandidatë të tjerë pritet të merret një vendim në fillim të vitit 2020. Lidhur me këtë proces, KLP ka marrë disa vendime: Vendim nr. 194, datë 03.10.2019, Vendim nr. 207, datë 11.10.2019, Vendim nr. 216, datë 25.10.2019 dhe Vendim nr. 252, datë 25.11.2019, "Për miratimin e listës pjesore të kandidatëve të pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës".

Gjithashtu, KLP, duke analizuar nevojat që sistemi ka dhe mundësitë që ka Shkolla e Magjistraturës, miratoi Vendimin "Për numrin e kandidatëve për t'u pranuar në programin fillestar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2019-2020"<sup>23</sup>, përkatësisht 25 pozicione për kandidatë për magjistratë prokurorë.

Në vijim të detyrimeve që ka KLP, në mbështetje të neneve 14 dhe 33, të Ligjit për statusin, me anë të Vendimit nr.45, datë 19.03.2019, "Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës", KLP miratoi magjistratët prokurorë udhëheqës për një periudhë tre-vjeçare (2017-2020), me të drejtë riemërimi.

Me Vendimin nr. 232, datë 12.11.2019, "Për pjesëmarrjen e prokurorëve në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës", KLP vendosi miratimin e kalendarit për aktivitetet trajnuese, për tre-mujorin e parë të vitit akademik 2019-2020, si dhe miratoi listën e ekspertëve/ lehtësues për aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës. KLP ka miratuar gjithashtu edhe programin mësimor/ kurrikulat e kësaj Shkolle.

#### 4.2 MARRËDHËNIET ME MINISTRINË E DREJTËSISË

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 773, datë 02.11.2016, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017-2020 dhe të planit të saj të veprimit", ku Ministria e Drejtësisë është institucion koordinues, ndërsa ministritë e linjës dhe institucionet e drejtësisë kanë detyrimin ligjor për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, KLP ka kryer një raportim të pjesshëm për periudhën janar-shtator 2019, ashtu sikurse një raportim të plotë për vitin 2020. Raporti fokusohet në mënyrë të veçantë, në procedurat e ndjekura për ngritjen e Prokurorisë së Posaçme, si dhe në procedurën e përzgjedhjes së Prokurorit të Përgjithshëm.

Së bashku me raportimin, KLP ka plotësuar të gjithë indikatorët që lidhen me veprimtarinë e tij, të përfshira në Planin e Veprimit, ku përfshihen: miratimi i akteve nënligjore, të dhëna statistikore lidhur me mbështetjen që ka dhënë KLP ndaj KPK, nëpërmjet hartimit të raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara për analizën e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, të dhëna mbi funksionimin e plotë të KLP, me

---

<sup>23</sup> Vendim nr. 21, datë 28.01.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

kuadrin rregullator, kapacitetet dhe infrastrukturën e nevojshme për të përmbushur funksionin, çështje të tjera të karakterit administrativ dhe infrastrukturor.

Gjithashtu, nga Ministria e Drejtësisë në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar është përcjellë për plotësim Pyetëtori i Komisionit European i Këshillit të Europës për Eficiencën e Drejtësisë (CEPEJ), nga KLP. Në përputhje me misionin e tij, CEPEJ vlerëson eficiencën e sistemeve të drejtësisë dhe propozon mjete dhe masa praktike për Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, për të punuar për një shërbim eficient në rritje të drejtësisë për publikun.

Pyetëtori synon të mbledhë të dhëna cilësore dhe sasiore nga 6 vende të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Shqipërinë që lidhen me funksionimin e sistemeve gjyqësore dhe lejojnë matjen më mirë të rezultateve të reformimit të sistemeve të drejtësisë në vendet e rajonit, reforma të cilat janë mbështetur nga Komisioni European.

Pyetëtori në fjalë i është dedikuar vendeve të Ballkanit Perëndimor, ndryshe nga Pyetësorët e tjerë që plotësohen çdo dy vjet nga të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës. Ai përmbante disa indikatorë të rinj dhe zgjeron fokusin e skemës ekzistuese duke përfshirë fusha me interes të veçantë për Komisionin European, veçanërisht në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin European të këtyre vendeve. Për këtë arsye, Pyetëtori zgjeron disa pyetje ekzistuese të CEPEJ si dhe përmban pyetje të reja lidhur me pavarësinë e drejtësisë, integritetin dhe luftën kundër korrupsionit, trajnimin, etj.

Së fundi, KLP ka dërguar në Ministrinë e Drejtësisë kontributin saj mbi zhvillimet e ndodhura gjatë vitit 2019, lidhur me parandalimin e korrupsionit tek prokurorët në zbatim të rekomandimeve të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), të adresuara në Raportin e Dytë të Përputhshmërisë për Shqipërinë, në kuadër të Raundit të IV-t të Vlerësimit.

Si pjesë e këtyre zhvillimeve, KLP ka informuar mbi veprimtarinë për përzgjedhjen e prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe përzgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm.

Në këtë raportim, KLP ka informuar në mënyrë të përmbledhur edhe përsa i takon procesit të rekrutimit të drejtuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, pas hapjes së garës dhe shpalljes së kriterëve dhe procedurës ligjore përkatëse.

KLP do të vijojë t'i kushtojë rëndësinë e duhur zbatimit të rekomandimeve të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), për parandalimin e korrupsionit tek prokurorët si parakusht për pavarësinë dhe luftën efektive kundër krimin në përgjithësi dhe atij të organizuar në veçanti, si dhe luftën kundër korrupsionit.

### 4.3 MARRËDHËNIET ME MINISTRINË PËR EUROPËN DHE PUNËT E JASHTME

KLP, në bashkëpunim me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, ka qenë pjesë e Grupit të Punës për përgatitjen e materialit, për takimin e dhjetë të Komitetit të Stabilizim Asociimit<sup>24</sup>, i cili u mbajt në Bruksel, më 14.11.2019.

Nga ana e shërbimeve të Komisionit European u dërguan disa pyetje, të cilat qenë pjesë e këtij takimi. Në këtë takim, KLP mori pjesë me përfaqësuesit e tij, të cilët raportuan me shkrim dhe me gojë për disa aktivitete, ku kryesisht spikati procedura e përzgjedhjes së Prokurorit të Përgjithshëm, pasi po në të njëjtën datë, pranë KLP u zhvilluan intervistat me tre kandidatët dhe u krye vlerësimi me pikë, për secilin prej tyre.

Në këtë takim, përfaqësuesit e Komisionit European u shprehën se shihet një trend progresiv në implementimin e Reformës në Drejtësi, duke përfshirë edhe procesin e Vetting-ut dhe luftën kundër korrupsionit, ashtu sikurse përshëndetën procesin transparent dhe të hapur që u realizua për përzgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm.

Nga shërbimet e Komisionit European, pas takimit të 10-të të Komitetit të Stabilizim-Asociimit janë dërguar rekomandimet përkatëse, ku për fushën e veprimtarisë së KLP nuk pati asnjë rekomandim për përmirësimin sa i përket zhvillimeve ligjore dhe institucionale.

Gjithashtu, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 246, datë 9.5.2018, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2018–2020”, KLP ka dhënë kontributin e tij në hartimin e Projekt-Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2020–2022, për Kriterin Politik dhe kapitullin 23 “Gjyqësori dhe liritë themelore”.

Sa i përket Raportit të Progresit të Komisionit European, KLP, në bashkëpunim me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme ka dhënë kontributin për hartimin e raportit të qeverisë Shqiptare mbi përparimin dhe arritjen e institucioneve publike në procesin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European, për periudhën janar-tetor 2019. Pritet që, raportimi vjetor të kryhet në fillim të vitit 2020.

Nëse i referohemi Raportit të Progresit të Komisionit European<sup>24</sup>, sa i përket ngritjes së institucioneve të reja të drejtësisë, Komisioni shprehet se institucionet e reja të vetëqeverisjes janë krijuar, gjë që përfaqëson një hap rrënjësor në forcimin e pavarësisë dhe paanësisë së sistemit të drejtësisë. Në raport shprehet gjithashtu se, Shqipëria duhet të ndjekë hapat për ngritjen e Strukturës së Posaçme Antikorrupsion.

### 4.4 MARRËDHËNIET ME PROKURORINË E PËRGJITHSHME DHE PROKURORITË E TË GJITHA NIVELEVE

Në zbatim të Ligjit për prokurorinë, për periudhën e raportimit, Prokurori i Përgjithshëm, në bashkëpunim me KLP, kanë kryer vlerësimin e numrit të prokurorëve për çdo

<sup>24</sup> Për më tepër, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

prokurori dhe kanë ripërcaktuar numrin e tyre, pasi kanë marrë mendimin e drejtuesve të prokurorive përkatëse dhe kanë vlerësuar ngarkesën e çdo prokurorie.

Vendimi për përcaktimin e numrit të prokurorëve për çdo prokurori pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Posaçme merr parasysh garantimin e një ngarkese të balancuar pune për të gjithë prokurorët dhe prokuroritë e vendit, ashtu sikurse sigurimin e aksesit të shtetasve në shërbimin e prokurorisë, rritjen e cilësisë së këtyre shërbimeve, uljen e shpenzimeve dhe përdorimin e të ardhurave në mënyrë eficiente.

Gjithashtu, KLP ka bashkëpunuar me Prokurorinë e Përgjithshme përgjatë vitit 2019, sa i përket procedimeve disiplinore të prokurorëve. Duke u mbështetur në Ligjin për statusin, ku përcaktohet në dispozitat kalimtare se, deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për shkeljet disiplinore të parashikuara në këtë ligj, do të përfundohen ndër të tjerë nga Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme. Në këtë kontekst, KLP ka përcjellë pranë Zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme propozimet për masë disiplinore, si organi kompetent për të ndjekur procedimet, për një periudhë tranzitore.

Në momentin e krijimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ky i fundit do të jetë autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve, dhe KLP nga ana e tij do të jetë organi që do të vendosë për pranimin apo rrëzimin e masës disiplinore të propozuar.

KLP njëkohësisht ka marrë pjesë në Analizën vjetore të Prokurorive, pranë Gjykatave të Juridiksionit të Përgjithshëm të të gjitha niveleve.

### 4.5 MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA TË RIVLERËSIMIT

KLP është organi i ngarkuar për vlerësimin e punës të prokurorëve duke përfshirë edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar.

Komisioni i Vlerësimit vlerëson punën, si dhe përgatit raportet e aftësive profesionale të prokurorëve, në kuadër të rivlerësimit kalimtar.

Me Vendimin nr. 32, datë 22.02.2019, KLP vendosi të komandojë 6 magjistratë, prokurorë, për hartimin e draft-raporteve të vlerësimit profesional në kuadër të rivlerësimit.

KLP ka miratuar dhe dorëzuar pranë KPK-së për periudhën janar –dhjetor 2019, gjithsej 83 raporte për vlerësimin e aftësive profesionale të prokurorëve, së bashku me materialet që kanë shërbyer për përgatitjen e tyre.

Për vitin 2019, KLP në bashkëpunim me KPK, kanë organizuar 118 shorte për përzgjedhjen e akteve që i përkasin 5 dosjeve të cilat kanë shërbyer për të përgatitur raportin e vlerësimit të aftësive profesionale të prokurorëve.

Në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit për rivlerësimin, anëtarët e KLP janë subjekte të rivlerësimit. Në këtë kontekst, gjatë procesit të rivlerësimit, nga ana e KPA, janë shkarkuar me vendim të formës së prerë, dy anëtarë prokurorë të KLP. Vendimi i KPA, që vendos shkarkimin nga detyra, ka efekt të menjëhershëm *ex lege*. Në vijim të vendimit të KPA, mbarimi i mandatit është deklaruar me vendim të KLP për këta dy anëtarë.

Gjithashtu, në rastet e prokurorëve, të cilët kanë kërkuar dorëheqjen, duke hequr dorë nga statusi i magjistratit, KLP ka përcjellë pranë organeve të rivlerësimit, KPK ose KPA, në varësi të fazës në të cilën ndodhej prokurori, vendimin për deklarimin e mbarimit të statusit, në mënyrë të KPK ose KPA të merrte vendim për pushimin e procesit të rivlerësimit.

#### 4.6 MARRËDHËNIET ME KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Sipas nenit 181 të Ligjit të qeverisjes, KLP raporton para Kuvendit jo më pak se një herë në vit. Gjatë vitit 2019, KLP ka raportuar për periudhën nga konstituimi i tij (19 dhjetor 2018) deri në 31 korrik 2019. Duke qenë raportimi i parë dhe për një periudhë më të shkurtër se një vit, Kuvendi nuk ka miratuar rezolutë, por raportimi është kryer pranë Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut.

KLP ka raportuar para Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut edhe në rastet e miratimit të numrit të përgjithshëm të punonjësve si dhe në rastin e buxhetit.

Gjithashtu në kuadër të detyrimeve për raportim para Kuvendit, KLP, përveç komunikimit shkresor me Komisionin e Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Reformës në Drejtësi duke iu përgjigjur pyetjeve dhe zbatuar rekomandimet e këtij komisioni, ka zhvilluar gjithashtu edhe një seancë dëgjimore me kërkesë të Komisionit.

Sipas nenit 187 të ligjit të qeverisjes, KLP është përgjegjës për të dhënë mendime dhe për të bërë propozime lidhur me ndryshimet në legjislacionin që mund të ndikojë në punën e prokurorisë dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e Këshillit. Në këtë kuadër gjatë vitit 2019, KLP me kërkesë të Kuvendit ka dhënë mendime për projektligje të ndryshme edhe në mënyrë shkresore edhe duke u bërë pjesë e diskutimeve në Komisionin e Ligjeve.

## 5 TRANSPARENCA INSTITUCIONALE E KËSHILLIT

### 5.1 PROCESI TRANSPARENT NDAJ INSTITUCIONEVE TË TJERË, PUBLIKUT DHE MEDIAVE

Menjëherë pas krijimit të KLP dhe në shërbim të transparencës, në muajin Janar 2019, KLP, në bashkëpunim me misionin EURALIUS është ndërtuar faqja zyrtare e Këshillit [www.klp.al](http://www.klp.al).

Gjithashtu, që me mbledhjen e parë të KLP të zhvilluar më datë 19.12.2019 dhe në vazhdim, të gjitha mbledhjet plenare kanë qenë të aksesueshme nga çdo institucion shtetëror, organizatë lokale dhe ndërkombëtare, media dhe nga çdo person fizik të interesuar, për përmbajtjen e vendimmarrjes së tyre, nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të regjistrimit audio, brenda 24 orëve nga data e zhvillimit të tyre, në zbatim të Ligjit për qeverisjen, neni 167, pika 2.

Në seancat plenare të Këshillit kanë qenë të pranishëm si vëzhgues, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, OSBE, misionet ndërkombëtare EURALIUS dhe OPDAT.

Komiteti i Helsinkit, në raportin e tij vjetor, është shprehur me nota pozitive përse i përket veprimtarisë së Këshillit, procesit të vendimmarrjes, transparencës ndaj publikut dhe institucioneve të tjera.

Më datë 24.09.2019, Kryetari i KLP, Z. Gent Ibrahimimi, po në kuadër të transparencës institucionale, ka raportuar për veprimtarinë e Këshillit nga data e themelimit të tij deri në muajin Korrik 2019, para Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Reformës në Drejtësi në një seancë të zhvilluar në ambientet e Kryesisë së Kuvendit.

Media ka qenë dhe mbetet partneri i pazëvendësueshëm i Këshillit, për të informuar dhe ndërgjegjësuar opinionin publik mbi misionin dhe rolin e KLP në zbatimin me sukses të Reformës në Drejtësi. Seancat plenare të Këshillit janë ndjekur në kohe reale nga mediat dhe janë zhvilluar në prezencë të tyre. Kërkesat për informim nga ana e medias kanë marrë përgjigje zyrtare brenda afateve të përcaktuara nga Ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Kanë qenë të shpeshta prononcimet për media të Kryetarit, Gent Ibrahimimi në emër të Këshillit, lidhur me veprimtarinë e Këshillit sidomos ato të cilat lidhen me dy procese të rëndësishme: përzgjedhja e prokuroreve për SPAK dhe zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm.

*Në emër të transparencës dhe për shkak të interesimit të madh të opinionit publik, Këshilli, intervistat me kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm dhe drejtues të Prokurorisë së Posaçme u transmetuan live në media.*



Njoftimet për mediat, konferencat për shtyp, intervistat dhe aktivitetet të tjera të KLP (ceremonia e inaugurimit të godinës, betimi i prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme para Presidentit, takime me përfaqësues diplomatik, organizata ndërkombëtare, pjesëmarrje në trajnime, seminare, takime bilaterale etj.) janë pasqyruar në faqen zyrtare të Këshillit.

KLP ka ndjekur me vëmendje çdo reagim dhe çdo deklaratë publike lidhur me punën e institucionit të prokurorisë dhe të prokurorëve të veçantë dhe ka inkurajuar deklariesit, si çdo subjekt tjetër publik ose privat, të denoncojnë pranë institucioneve ligjzbatuese, të gjitha rastet e dyshuara të kryerjes së veprave penale nga çdo prokuror i Republikës, ndërsa dyshimet për kryerjen e shkeljeve disiplinore u orientuan të denoncoheshin pranë Prokurorit të Përgjithshëm në zbatim të parashikimit ligjor në dispozitat kalimtare të Ligjit për statusin.

### 5.2 PROCEDURAT E NDJEKURA NË KUADËR TË SË DREJTËS PËR INFORMIM

KLP, në zbatim të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, përgjatë gjashtëmujorit të dytë, të vitit 2019, me qëllim nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë, në raport me garantimin e njohjes së publikut me informacionin që prodhohet ose mbahet nga ky këshill, ka përfunduar procesin e përgatitjes së dokumentacionit të kërkuar, si detyrim ligjor nga ana e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Në këtë kuadër, KLP ka hartuar një program institucional të transparencës, ku ka përcaktuar kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyrën e bërjes publike të këtij informacioni.

Programi i Transparencës, ka synuar garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik, për të cilin nuk është e nevojshme kryerja e një kërkesë. Çdo informacion i bërë publik pa kërkesë është i ndërlidhur me Programin e Transparencës dhe do të bëhet i aksesueshëm lehtë në faqen zyrtare të KLP<sup>25</sup>, në fillim të vitit 2020.

Sikurse ka rekomanduar Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale (Rekomandimi nr. 54, datë 30.10.2019 “Për programin e transparencës së Autoritetit Publik “Këshilli i Lartë i Prokurorisë”), KLP ka përgatitur për të publikuar në faqen e web-it, një seri dokumentacioni që lidhet me organizimin e brendshëm të institucionit, ku përfshihen: përbërja e këshillit, organigrama, struktura e pagave, detajimi i buxhetit, Projekt-Buxheti Afat-Mesëm (2020-2022) etj.

Gjithashtu, KLP ka përgatitur për publikim, përmbledhjen e paketës ligjore të Reformës në Drejtësi, në të cilën janë përfshirë të gjithë aktet ligjore, me të cilët lidhet veprimtaria e këtij institucioni, duke nisur nga Kushtetuta me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, Ligji Nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, Ligji për statusin, në variantin e tij të konsoliduar,

<sup>25</sup><https://klp.al/>

pas shfuqizimit të disa dispozitave me Vendimin nr. 34/2017, Gjykatës Kushtetuese dhe pas ndryshimeve të pësuara me Ligjin Nr. 48/2019, Ligji për qeverisjen, pas shfuqizimit të disa dispozitave me Vendimin nr. 41/2017 dhe 78/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe pas ndryshimeve të pësuara me Ligjin Nr 47/2019, Ligj për prokurorinë, ashtu sikurse të gjitha vendimet dhe aktet e tjerë administrative të nxjerrë nga Këshilli”.

Për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ligji për të drejtën e informimit, përveç programit të transparencës, KLP ka krijuar një regjistër të posaçëm, ku do të pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre.

Gjithashtu KLP, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, ka caktuar një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit.

Programi i Transparencës, së bashku me informacionet e sipërpërmendura janë parashikuar të publikohen në fillim të vitit 2020 dhe do të përditësohen sipas kërkesave të ligjit për të drejtën e informimit.

## 6 NGRITJA E PROKURORISË SË POSAÇME

### 6.1 HARTIMI DHE MIRATIMI I RREGULLORES PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE VLERËSIMIT TË PROKURORËVE NË PROKURORINË E POSAÇME

KLP është autoriteti kompetent për emërimin e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, bazuar në nenin 179/8 të Kushtetutës, nenin 4/2 të ligjit “Për statusin e organizimit dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe nenin 48/2 dhe 3 të Ligjit për statusin.

KLP, më datë 7 janar 2019, njoftoi fillimin e procedurave për plotësimin e 15 pozicioneve në Prokurorinë e Posaçme. Në fund të afatit, më 21 shkurt 2019, 28 kandidatë aplikuan, ku vetëm 25 prej tyre plotësuan kushtet ligjore për të vazhduar garën për prokurorë të posaçëm.

Njëkohësisht me shpalljen e vendeve vakante, nisi puna për hartimin e Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”. Procesi i hartimit të Rregullores është mbështetur nga ekspertët e OPDAT dhe EURALIUS. Rregullorja është miratuar me Vendim nr. 51, datë 19.03.2019, të KLP dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 44, datë 29.03.2019. Në të njëjtën datë, rregullorja ka hyrë në fuqi.

### 6.2 GARA PËR PROKUROR NË PROKURORINË E POSAÇME

Numri i kandidatëve për prokuror të posaçëm arriti në 24, si rezultat i dorëheqjes nga konkurrimi dhe zgjedhjes anëtar në KLP të prokurorit Z. Vatë Staka.

Gjithashtu, një kandidat, më datë 27.5.2019, paraqiti kërkesën për dorëheqje nga procesi i vlerësimit për prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme, regjistruar me nr. 462 Prot., dhe Këshilli me Vendim nr. 57/1, datë 12.6.2019, vendosi ndërprerjen e garës për këtë kandidat.

Ndërsa një kandidat është shkarkuar nga detyra nga KPK më datë 26.06.2019. Deri në përfundim të vlerësimit të këtij subjekti, ai konsiderohet i pezulluar dhe nuk vijon të ushtrojë detyrën e prokurorit. Për këtë shkak, KLP me vendim nr.118, datë 28.6.2019, ka vendosur pezullimin e garës.

KLP ngriti një Komision të Posaçëm, i cili vendosi një komunikim zyrtar me kandidatët. Pas një pune intensive dhe diskutimeve të gjata, Komisioni ka bërë vlerësimin lidhur me kualifikimin e kandidatëve sipas kriterëve të parashikuara Rregullore.

Nga 22 kandidatët në garë për prokurorë, pas procesit të intervistimit të zhvilluar gjatë muajit korrik 2019, u përzgjedhën 15 kandidatët për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme. KLP, me Vendimin nr. 137, datë 16.07.2019, miratoi listën me renditjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme<sup>26</sup>.

Me vendimin nr. 234, datë 12.11.2019, “Për një ndryshim në vendimin nr. 137, datë 16.07.2019, “Për miratimin e listës me renditjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme”, KLP kreu ndryshimet përkatëse në renditjen e kandidatëve, duke ndaluar kandidimin e dy prokurorëve, njëri prej të cilëve u dekretua nga Presidenti i Republikës si anëtar i Gjykatës Kushtetuese, dhe kandidati tjetër, i cili u tërhoq zyrtarisht nga gara.

### 6.3 EMËRIMI I PROKURORËVE TË KONFIRMUAR NË DETYRË DHE GARA PËR DREJTUES TË PROKURORISË SË POSAÇME

Më 25 Nëntor 2019, KLP vendosi që tetë kandidatët për prokurorë të Prokurorisë së Posaçme, të cilët e kanë kaluar procesin e rivlerësimit dhe kanë marrë konfirmimin në detyrë me vendim të formës së prerë, të emërohen prokurorë të Prokurorisë së Posaçme. Ndërkohë, KLP i ftoi ata për të shprehur interesin dhe për të aplikuar për ngritje në detyrë, në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Afati i aplikimit u vendos të ishte 10 Dhjetor 2019.

Njëkohësisht, me vendimin nr. 237, datë 25.11.2019, “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e kandidatëve për drejtues të Prokurorisë së Posaçme”, KLP miratoi një dokument të brendshëm pune, i cili synonte të orientonte anëtarët në vlerësimin e kandidatëve për drejtues në Prokurorinë e Posaçme.

Përveç dokumentacionit që provonte aftësitë dhe kualifikimin (*letrat e motivimit të kandidatëve, akte të procedimeve penale dhe procedimeve pasurore të sjella nga vetë kandidatët, akte të procedimeve penale të kërkuara nga anëtarët e Komisionit, si dhe informacione nga burime të tjera*), kandidatët për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme iu

---


<sup>26</sup><http://klp.al/wp-content/uploads/2019/07/Nr.137-Dat%C3%AB-16.07.2019.pdf>

nënshtroan edhe procesit të intervistimit nga KLP, në prezencë dhe me pjesëmarrjen e ekspertëve të misioneve OPDAT dhe EURALIUS.

Tre kandidatë prej tetë prokurorëve të SPAK shprehën interesin për pozicionin e drejtuesit të SPAK, konkretisht: Z. Altin Dumani, Z. Arben Kraja, dhe Z. Edvin Kondili.

Më 12.12.2019, KLP emëroi tetë kandidatët prokurorë të Prokurorisë së Posaçme, duke patur një periudhë tranzitore, prej momentit të marrjes së vendimit dhe deri në fillimin e punës së tyre.

Më 18.12.2019, tre kandidatët për drejtues të Prokurorisë së Posaçme u intervistuan nga ana e anëtarëve të Këshillit, nga partnerët ndërkombëtarë OPDAT dhe EURALIUS, në prezencën e mediave.



Në të njëjtën ditë, KLP kreu renditjen e tri kandidatëve për drejtues të Prokurorisë së Posaçme, ku Z. Arben Kraja u emërua drejtues me vendimin nr. 281, datë 19.12.2019, pas votimit i cili rezultoi me 6 vota nga 11 në total.

### 6.4 KANDIDATËT E TJERË PËR PROKUROR NË PROKURORINË E POSAÇME NË PROCES RIVLERËSIMI

Sa i përket kandidatëve të tjerë për prokuror të Prokurorisë së Posaçme, KPK ka konfirmuar në detyrë dy kandidatë.

Gjithashtu, përsa i përket kandidatëve të tjerë për prokurorë të SPAK:

1. 1 kandidate është konfirmuar nga KPK, por ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga Komisioneri Publik. Për të nuk ka ende një vendim të formës së prerë.

Nuk është shpallur akoma data e shqyrtimit nga ana e KPA, por është krijuar trupa që do e vlerësojë rastin.

2. Për dy kandidatë është marrë vendim konfirmimi në detyrë nga KPK, por këto vendime nuk janë zbardhur ende.
3. Një kandidat është në proces vlerësimi nga KPK dhe pritet data e radhës e seancës.
4. Për një kandidat nuk ka asnjë datë të parashikuar.

Me vendimin nr. 282, datë 19.12.2019, “Për miratimin e rregullave të transferimit të personelit administrativ të Prokurorive të Krimeve të Rënda”, KLP ka përcaktuar rregullat për transferimin e personelit administrativ nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

## 7 PROCESI I PËRZGJEDHJES SË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SËSHQIPËRISË

### 7.1 RREGULLORJA DHE SHPALLJA

KLP është organi përgjegjës për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm. Në këtë kuadër, me Vendimin nr. 50, datë 19.03.2019, Këshilli miratoi rregulloren “Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm”, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 44/2019 dhe hyrë në fuqi më datë 29.3.2019.

Procesi i hartimit të Rregullores u mbështet nga ekspertët e misioneve OPDAT dhe EURALIUS. Më tej, KLP shpalli ftesën për paraqitjen e shprehjeve të interesit për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm, në faqen e tij zyrtare, ku përcaktohej se afati për të shprehur interesin për Prokuror të Përgjithshëm është 30 ditë<sup>27</sup>.

Përsa më sipër, në mbyllje të afatit të vendosur nga KLP (datë 29.04.2019) shprehën interes për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm 4 kandidatë (*Znj. Arta Marku, Znj. Fatjona Memçaj, Z. Lulzim Alushaj dhe Z. Olsian Çela*).

### 7.2 VERIFIKIMI I KUSHTEVE LIGJORE

Brenda 45 ditëve nga përfundimi i afatit të dorëzimit të shprehjes së interesit nga kandidatët, KLP kreu verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore që duhet të plotësonin kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, sipas legjislacionit në fuqi. Ndërkohë po në zbatim të dispozitave ligjore, KLP priti dhe përfundimin e procedurave të rivlerësimit për

<sup>27</sup><http://klp.al/index.php/2019/04/01/keshilli-i-larte-i-prokurorise-shpall-fillimin-e-procedures-per-perzgjedhjen-e-kandidateve-per-prokuror-te-pergjithshem-permes-procedures-se-hapur-te-thirrjes-publike-per-aplikim-bazuar-ne-rregullor/>

kandidatët që i nënshtrohen këtij procesi deri në konfirmimin e tyre. KLP iu drejtua zyrtarisht KPK, për të mundësuar rivlerësimin me përparësi të kandidatit Z. Olsian Çela, në mënyrë që procesi të përfundonte brenda afatit ligjor.

Për të përmbushur detyrimin e tij për verifikimin e kushteve ligjore për kandidatët, KLP, në zbatim të nenit 31 të ligjit Për Prokurorinë shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe kërkoi raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, si dhe të çdo shkakut tjetër përjashtues. Këto institucione janë ILDKPKI, organet e administratës tatimore dhe doganore, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ i Shtetit, Autoriteti për Informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit etj.

KLP, me Vendimin nr. 109, datë 17.06.2019, vendosi të shtyjë afatin 45 ditor për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët në garë, deri në përfundimin e këtij procesi për kandidatin Z. Olsian Çela.

### 7.3 MIRATIMI I LISTËS PARAPRAKE TË KANDIDATËVE PËR PROKUROR TË PËRGJITHSHËM

Në mbledhjen e KLP, më 25.09.2019, me marrjen e vendimit përfundimtar të konfirmimit në detyrë të kandidatit z. Olsian Çela nga organet e Vetting-ut, u miratua lista përfundimtare me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet për të vijuar garën për Prokuror të Përgjithshëm, si më poshtë:

- *Znj. Arta Marku;*
- *Z. Olsian Çela;*
- *Znj. Fatjona Memçaj.*

Të tre kandidatët rezultuan se i plotësonin kushtet për të vijuar garën më tej, ndërkohë që një kandidati iu ndalua vijimi i kandidimit, pasi nuk plotësonte kushtin e vjetërsisë në punë si jurist i spikatur, si dhe kishte mungesë dokumentacioni (dy vetëdeklarime). Me vendimin nr. 169, datë 25.09.2019, KLP vendosi ndalimin e kandidimit të kandidatit për Prokuror të Përgjithshëm<sup>28</sup>.

Kandidati të cilit iu ndalua kandidimi, ushtroi të drejtën e padisë pranë Gjykatës Administrative të Apelit me objekt: Shfuqizimin e vendimit nr.169, datë 25.09.2019 dhe, si pasojë, anulimin e plotë të të gjithë akteve dhe procedurës së ndjekur në lidhje me afatet dhe vendimmarrjen mbi verifikimin e kushteve ligjore të kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm, vënë në zbatim KLP dhe njoftuar paditësit me datë 30.09.2019. Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë, vendosi rrëzimin e kërkesë padisë me pasojë lënien në fuqi të vendimit të KLP.

---

<sup>28</sup><https://klp.al/wp-content/uploads/2019/09/vendim-nr-169-25.09.2019-1.pdf>

### 7.4 MIRATIMI I LISTËS PËRFUNDIMTARE TË KANDIDATËVE PËR PROKUROR TË PËRGJITHSHËM

Më tej, KLP me vendimin nr. 228, datë 29.10.2019, vendosi miratimin e listës me emrat e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm, të cilët plotësonin kushtet ligjore për këtë pozicion, pas vlerësimit paraprak, dhe me Vendimin nr. 229, datë 12.11.2019,

KLP miratoi “Metodologjinë për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm”.

Më datë 13.11.2019, KLP organizoi seancën dëgjimore me të tre kandidatët. KLP kreu njëkohësisht vlerësimin e kandidatëve sipas kritereve të parashikuara në ligj dhe rregullore, pikëzimin dhe renditjen e tyre.

Intervistat u zhvilluan në prezencë të anëtarëve të Këshillit, partnerëve ndërkombëtarë, EURALIUS, OPDAT dhe mediave. Secili prej kandidatëve iu përgjigj pyetjeve përkatëse dhe paraqiti platformën e tij personale, që do të shqyrtohej më pas nga Këshilli.

Më datë 14.11.2019, Këshilli miratoi renditjen e tre kandidatëve sipas pikëve:

- *Olsian Çela (459 pikë);*
- *Arta Marku (406 pikë);*
- *Fatjona Memçaj (362 pikë).*

Pas këtij procesi, kandidatët kishin të drejtë të ankimonin në gjykatë vendimin e KLP, brenda tri ditëve nga data e njoftimit të tij, por asnjë prej kandidatëve nuk e ezauroi këtë të drejtë.

### 7.5 ZGJEDHJA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM NGA KUVENDI

Më tej, KLP i paraqiti Kuvendit të Shqipërisë vendimin e arsyetuar, që përmbante propozimin e listës me tre kandidatët që janë renditur me pikët më të larta, duke filluar nga kandidati me më shumë pike, tek kandidati me më pak pikë.

Prokurori i Përgjithshëm emërohet sipas nenit 148/a të Kushtetutës, ku përcaktohet se zgjidhet me tre të pestat e anëtarëve të Kuvendit, mes tre kandidatëve të propozuar nga KLP, për një mandat 7-vjeçar dhe pa të drejtë riemërimi. Nëse Kuvendi nuk

***Më 05.12.2019, me Vendimin Nr. 138/2019, Kuvendi I Republikës së Shqipërisë zgjodhi në funksionin e Prokurorit të Përgjithshëm, Kandidat i cili u Rendit i pari edhe nga vlerësimi i KLP***

***Z. OLSIAN ÇELA***

Në progres-raportin për Shqipërinë 2018, Komisioni European ka publikuar disa nga kriteret kryesore të vlerësimit duke theksuar se reforma në drejtësi po zbatohet e plotë dhe gjithëpërfshirëse ku rivlerësimi i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve (procesi i Vetting-ut) ka filluar. Raporti shprehet qartë se Shqipëria duhet të avancojë në zbatimin e reformës në drejtësi me përfundimin e krijimit të strukturave të reja gjyqësore (Këshilli i Lartë i Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli i Emërimit të Drejtësisë) dhe arritja e rezultateve të para në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Roli i ndërkombëtarëve ka qenë decisiv në zbatimin e reformës në drejtësi në Shqipëri. Në vitin e parë të krijimit të Këshillit, vëmendja e autoriteteve ndërkombëtare, përfshi këtu trupat diplomatikë të akredituara në vend, institucione homologe në vende të ndryshme, organizatat ndërkombëtare të cilat monitorojnë zbatimin e reformës në drejtësi në vendin tonë kanë treguar një interesim të madh përse i përket mbarëvajtjes së veprimtarisë së Këshillit në realizimin e objektivave dhe detyrimeve të tij kushtetuese.

**Gjatë vitit 2019, Kryetari Gent Ibrahimi dhe anëtare të tjerë të Këshillit kanë organizuar takime punë me misione të rëndësishme ndërkombëtare si:**

- Përfaqësues të Byrosë Ndërkombëtare të Zbatimit të Ligjit dhe Luftës ndaj Drogës (International Narcotics and Law Enforcement) shoqëruar nga e ngarkuara me punë e Ambasadës Amerikane **Leyla Moses**.
- Takimi me Zëvendës/Ndihmës Sekretari i Shtetit të SHBA-së, **Jorgan K. Andrews** si dhe përfaqësuesit e misionit amerikan OPDAT/ICITAP.
- Takimi me Drejtoreshën e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM), njëkohësisht dhe Drejtoreshë për Ballkanin Perëndimor, në departamentin për Fqinjësinë dhe Negociatat për Zgjerim, **Genoveva Ruiz Calavera**.
- Takimi me Zëvendës Presidentin e Këshillit të Lartë të Magjistraturës në Itali, avokat **David Ermini**, me Prokurorin e Përgjithshëm të Mbretërisë së Holandës, z.**Gerrit van der Brug** dhe presidentin e Eurojust, **Ladislav Hamran**.
- Takime me ambasadorë të vendeve partnere të akreditur në Shqipëri, të cilët kanë një rol të rëndësishëm në zbatimin me sukses të reformës në drejtësi. Më rëndësi të veçantë kanë qenë takimet me ambasadorin e Bashkimit European në Tiranë, **Luigi Soreca**, ambasadorin e Italisë, Alberto **Cutillo**, ambasadoren e Holandës, **Guusje Korthals Altes** dhe ambasadoren e Gjermanisë, **Susanne Schütz**.

Gjatë këtyre takimeve, z. Ibrahimi ka nënvizuar faktin se nevoja për reformë në drejtësi ishte domosdoshmeri sepse në vend kishte ardhur koha për një ridimensionim të sistemit të drejtësisë. Ekspertët më të mirë ndërkombëtarë, kanë analizuar dobësitë dhe problemet



e sistemit, larg ndikimit politik duke hartuar strategjinë e zbatimit të reformës në respekt të praktikave më të mirat, të ligjeve ndërkombëtare duke synuar luftën kundër korrupsionit në sistem, pavarësinë dhe kredibilitetin e këtij sistemi të ri drejtësie.

*Në emër të Këshillit, Kryetari Gent Ibrahimi ka vlerësuar maksimalisht mbështetja e pakursyer të faktorit ndërkombëtar si dhe suportin financiar dhe ekspertizën profesionale, e cila nuk i ka munguar Këshillit gjatë vitit të parë të punës së tij.*

Në një qendrim të unifikuar, partnerët ndërkombëtar kanë shprehur bindjen e tyre se:

***Reforma në drejtësi do të sigurojë që çdokush të jetë i barabartë përpara ligjit vetëm kur drejtësia të fillojë funksionojë dhe institucionet do të jenë më të forta.***

Gjatë 2019, Këshilli ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme;

- ✓ konferenca apo tryeza të rrumbullakta të organizuara nga institucione të cilët veprojnë në fushën e zbatimit dhe monitorimit të reformës në drejtësi, si Presidenca, Kuvendi, Ministria e Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës.
- ✓ trajnime dhe seminare të organizuara nga misionet ndërkombëtare të asistencës EURALIUS, OPDAT, Komiteti i Helsinkit etj. të cilat kanë ofruar ekspertizën e tyre përsa i përket fuqizimi i pavarësisë, transparencës, efikasitetit, përgjegjshmërisë dhe besimit publik në sistemin shqiptar të drejtësisë, në pajtim me të drejtën dhe praktikën më të mira të BE-së.

### 9 KONKLUZIONE

Në zbatim të detyrimeve ligjore që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe kuadri ligjor përkatës për reformën në drejtësi, KLP është marrë me aktivitete të natyrave të ndryshme, duke nisur nga hartimi dhe miratimi i akteve me karakter të brendshëm rregullues, akteve me karakter nënligjor, akteve individuale në lidhje me statusin e prokurorëve dhe ngritjes së strukturave të posaçme në mbështetje të institucionit, ashtu sikurse të strukturave të tjera që duhet të ngriheshin për shkak të ligjit.

KLP, për periudhën janar- dhjetor 2019, është hasur me vështirësi dhe sfida të mëdha, për kryerjen e detyrave funksionale të tij, si: mungesa e burimeve njerëzore dhe vështirësitë infrastrukturore nga njëra anë, ashtu sikurse mungesa e bazës ligjore e nënligjore për të bërë sa më efektiv Ligjin për qeverisjen dhe Ligjin për statusin.

Një sfidë më vete për KLP ishte dhe hartimi i akteve dhe ngritja e mirëfilltë e strukturave përgjegjëse për shqyrtimin e karrierës së prokurorëve (karrierë e cila përfshin që nga kandidimi për magistratë në Shkollën e Magjistraturës, tek kandidimi për prokurorë, apo tek ata që kanë dalë nga sistemi i Prokurorisë dhe kërkojnë të rikthehen në karrierën e prokurorit, ashtu sikurse procedura e ngritjes në detyrë të këtyre të fundit).

Gjithashtu, KLP, në ushtrim të kompetencave të tij, ka pasur në fokus të veçantë, krijimin e Prokurorisë së Posaçme, si një prej detyrimeve ligjore më të rëndësishme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në vëmendje jo vetëm të institucioneve ligjzbatuese në vend, por edhe të faktorit ndërkombëtar. Për të arritur rezultate të prekshme dhe me efekte që pritet të vijnë shpejt, KLP miratoi gjithashtu Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, ashtu sikurse ngriti një Komision të Posaçëm për vlerësimin e kandidatëve për Prokurorinë e Posaçme dhe ku ky i fundit miratoi “Metodologjinë e punës së Komisionit të Posaçëm për vlerësimin e kandidatëve për Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”.

Në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga ligjet e posaçme, një prej veprimtarive të suksesshme të këtij institucioni është edhe përfundimi i procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm, bazuar në Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm”, të miratuara nga KLP, me qëllim që përzgjedhja, renditja dhe propozimi i tre kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të kryhej përmes një procesi objektiv, transparent, dhe gjithëpërfshirës.

Ndër sfidat me të cilat është hasur KLP, mund të përmendim vakumin e krijuar në sistemin e drejtimit në prokuroritë si pasojë e shkarkimit të drejtuesve të prokurorive gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Njëkohësisht, disa nga veprimtaritë e tjera me efekte të menjëhershme dhe me rezultate të dukshme, janë rregulloret e hartuara dhe miratuara nga KLP.

Në vijim, priten të miratohen edhe disa Rregullore të tjera, po aq të rëndësishme sa ato të sipërpërmendura, për të cilat ka përfunduar procesi i hartimit dhe po ndiqen procedurat e konsultimeve paraprake, përpara miratimit në Këshill.

*Sa më sipër, dhe në përfundim të këtij raporti, mund të konstatojmë se, KLP dhe komisionet e ngritura pranë tij (të përhershëm, të përkohshme dhe ad hoc) gjatë periudhës së raportimit, kanë kryer një veprimtari intensive dhe kanë realizuar detyrimet ligjore me rezultate të kënaqshme.*

KLP do të vijojë aktivitetin e tij bazuar në ligj, me vullnetin e plotë për të realizuar detyrimet ligjore në mënyre eficiente dhe efektive, ashtu sikurse do të ketë në vëmendje edhe përmirësimin e veprimtarisë për aspekte, për të cilat janë shfaqur problematika të caktuara gjatë punës.

## 10 PRIORITETET E KËSHILLIT PËR TRI VITET NË VIJIM

### 10.1 OBJEKTIVAT E KLP PËR VITIN 2020

Në ndjekje të objektivit madhor të instalimit të meritokracisë në jetën profesionale të prokurorëve, KLP, gjatë vitit 2020, do t'i japë përparësi finalizimit dhe miratimit të një serie aktesh nënligjore normative të cilat do të normojnë administrimin e karrierës së prokurorëve në përputhje me meritat profesionale të secilit. Aktet në fjalë do të rregullojnë në detaj: (i) vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve duke bërë matjen dhe individualizimin e performancës profesionale të secilit; (ii) lëvizjen paralele të prokurorëve nga një pozicion në tjetrin duke zhdërvjelltësuar administrimin e burimeve njerëzore në sistemin e prokurorisë; dhe (iii) ngritjen në detyrë të prokurorëve sipas rezultateve të tyre në punë duke hedhur në këtë mënyrë themelet e një sistemi ku sundon merita profesionale dhe integriteti. Aktet sipërpërmendura janë tashmë të hartuara dhe në fazën e konsultimit. Në këtë kontekst KLP do të nisë gjithashtu punën për hartimin e akteve të tjera nënligjore që zbatojnë plotësisht legjislacionin në fuqi, që rregullon statusin e prokurorëve, të tilla si rregullorja për komandimet, rregullorja për transferimet etj.

Sa i takon objektivave në drejtim të konsolidimit të mëtejshëm në funksionimin e KLP, gjatë vitit 2020 do të finalizohet dhe miratohet edhe rregullorja e rëndësishme e organizimit të brendshëm të Këshillit e cila do të detajojë procesin vendimmarrës brenda Këshillit por edhe linjat e komunikimit dhe të veprimit administrativ në funksion të realizimit të detyrave dhe objektivave.

Një prioritet tjetër është vijimi i procedurave për përzgjedhjen e prokurorëve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme (për të përmbushur numrin prej 15 prokurorësh të miratuar me vendim të KLP). Deri në fund të vitit 2019, KLP arriti të emëronte përfundimisht në

SPAK 9 nga 15 prokurorët e përzgjedhur (për shkak të vonesave në procesin e vetting-ut). Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020 KLP do të emërojë edhe 3 prokurorë të tjerë në SPAK. Në pjesën tjetër të vitit, duke shpresuar përfundimin e procesit të vetting-ut për kandidatët, KLP do të plotësojë edhe 3 vakancat e mbetura

Gjithashtu, në kuadër të përmirësimeve legislative, KLP ka marrë pjesë në Grupin e Punës, në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut pranë Kuvendit të RSH, për ndryshimet e disa dispozitave të ligjit për statusin. Duke pasur parasysh vështirësitë dhe problematikat e hasura gjatë veprimtarisë ditore të KLP, një objektiv për vitin 2020 do të ishte rishikimi dhe propozimi i disa ndryshimeve të tjera në ligjin për statusin, ashtu sikurse në ligjin për qeverisjen.

Së fundi, një objektiv i rëndësishëm për vitin 2020 është përmirësimi i kushteve infrastrukturore. Së pari, brenda 6-mujorit të parë, pritet fillimi i veprimtarisë pranë godinës së “Polit të Drejtësisë”. Së dyti, në kuadër të transparencës dhe gjithashtu në përmbushje të detyrimeve ligjore, KLP ka parashikuar një fond të posaçëm për pajisjen e sallës ku do të zhvillohen seancat plenare, me kushtet e përshtatshme për kryerjen e regjistrimeve audio, ashtu sikurse të pajisjeve të tjera elektronike të nevojshme.

### 10.2 PLANI STRATEGJIK I KLP (2020-2024)


Gjatë vitit 2019, Këshilli, në bashkëpunim me ekspertët e misionit EURALIUS kanë filluar punën për hartimin e Planit Strategjik 2020-2024 të KLP<sup>29</sup>. Ky plan përcakton objektivat e punës së KLP, për sigurimin e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe të efikasitetit në administrimin e sistemit të prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.

Drejtimet dhe veprimtaritë kryesore të punës sipas këtij plani strategjik do të realizohen bazuar në organizimin e ri institucional për qeverisjen e sistemit të drejtësisë, duke respektuar dispozitat kushtetuese dhe ligjore, objektivat strategjike sektoriale, si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Plani Strategjik 2020 – 2024 përmban vizionin, misionin dhe vlerat thelbësore që do të drejtojnë punën e këtij Këshilli, për arritjen e një qëllimi të përgjithshëm që është kontributi përforcimin e shtetit ligjor dhe krijimi i një sistemi të pavarur dhe eficient të prokurorisë që të kontribuojë në mënyrë efektive në luftën kundër krimit, duke garantuar respektimin e të drejtave të njeriut dhe rritjen e besimit të publikut.

Plani përmban aktivitetet kryesore të punës së KLP në 5 vitet në vijim, që do të shërbejnë për të garantuar meritokracinë, përgjegjshmërinë, profesionalizmin dhe pavarësinë e prokurorëve.

<sup>29</sup>Neni 180, i Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar



Ai është i organizuar në 6 programe të cilat trajtojnë çështjet si, ngritja e një administrate efektive dhe eficiente të Këshillit, promovimi i prokurorëve bazuar në meritën, kualifikimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi i punës sipas standardeve, llogaridhënia, garantimi i pavarësisë si dhe kontributi për rishikimin e legjislacionit.

Secili prej këtyre programeve shoqërohet nga një kalendar veprimi me aktivitete të detajuara në fushat respektive që do të ndiqen nga komisionet e përhershme pranë Këshillit.

Gjatë hartimit të këtij plani janë vlerësuar sfidat dhe rreziqet e mundshme, të përgjithshme, të brendshme apo të jashtme, të natyrave të ndryshme që mund të ndikojnë në punën e Këshillit, si dhe masat lehtësuese për shmangien apo uljen e efektit të dëmshëm të shkaktuar nga këto rreziqe. Plani përmban edhe indikatorët e performancës, ku përfshihen vlerat referuese dhe mjetet e verifikimit me qëllim zbatimin e tij.

Miratimi i Planit Strategjik 2020-2024 brenda 4-mujorit të parë të vitit 2020 përbën një nga prioritetet e punës së Këshillit.